



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 156

Tiranë – E hënë, 7 gusht 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar nr. 2125, datë 3.8.2017	7317
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 25.7.2017	7317
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 57, datë 25.7.2017	7322
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 58, datë 25.7.2017	7326
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 59, datë 28.7.2017	7332
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 60, datë 31.7.2017	7337
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 61, datë 31.7.2017	7342

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 62, datë 31.7.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 526, datë 18.10.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	7345
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 63, datë 31.7.2017	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.....	7350
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Fetih Shyqyri Tarko.....	7356
	Korrigjim gabimi material, në vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 97, datë 4.7.2017, “Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 146, datë 18 korrik 2017.....	7356

**URDHËR****Nr. 2125, datë 3.8.2017****PËR DELEGIM TË PËRKOSSHËM TË
KOMPETENCAVE**

Në zbatim të nenit 28 dhe nenit 29 të Kodit të Procedurave Administrative, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, neni 26 i Rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin nr. 1, datë 14.1.2015, të Kryeministrit “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Drejtorit të Drejtorisë së Vettingut dhe Sigurimit Industrial, z. Mark Ndreca.

2. Ky urdhër do të jetë në fuqi për periudhën 4.8.2017 deri 15.8.2017.

3. Z. Ndreca nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Ndreca, Drejtor i Drejtorisë së Vettingut dhe Sigurimit Industrial dhe strukturat përgjegjëse.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR
Dorian Tola

VENDIM**Nr. 56, datë 25.7.2017****NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 2.5.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 15 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Vodafone Albania” sh.a.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj Drejtoria e Apelitit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2016-2904, datë 30.3.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 30, 49 dhe 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, parashtrimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:**I**

1. Nga materialet e çështjes rezulton se pas kontrollit të ushtruar në shoqërinë “Vodafone Albania” sh.a. nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT) të Tatimpaguesve të Mëdhenj është mbajtur raportkontrolli i datës 9.6.2015, në bazë të të cilit është nxjerrë akti administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore me nr. 3339/6 Prot., datë 9.6.2015, sipas të cilit ajo duhet të paguajë detyrimet tatimore së bashku me gjobat në vlerën 293.595.809 lekë.

2. Ndaj këtij akti administrativ shoqëria “Vodafone Albania” sh.a. (kërkuessa) ka ushtruar ankim pranë Drejtorisë së Apelitit Tatimor (DAT) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Kjo e fundit, me vendimin nr. 21871/3, datë 12.10.2015, ka vendosur: “Refuzimin e ankimit për shkak se nuk është paguar apo nuk është vënë garanci bankare për detyrimin e plotë tatimor objekt ankimi (kamatëvonesat e TVSH-së për



periudhën 2011/2012, në shumën 5.075.734 lekë) sipas njoftim vlerësimi nr. 3339/6 Prot., datë 9.6.2015, nxjerrë nga DRT e Tatimpaguesve të Mëdhenj”, me argumentimin se në sistemin informatik konstatohet se ndaj shoqërisë është llogaritur edhe kamatëvonesë për detyrimin për TVSH-në për periudhën dhjetor 2011, në shumën 5.075.734 lekë.

3. Kërkuesja i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt shfuqizimin e akteve të mësipërme administrative.

4. Gjatë gjykimit nga ana e palëve të paditura është kërkuar në gjykim nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, me pretendimin se akti administrativ Njoftim Vlerësimi nuk mund të merret në shqyrtim nga gjykata në kushtet kur ai nuk është marrë më parë në shqyrtim nga organi administrativ epror, pasi pala paditëse në gjykim (kërkuesja) i është drejtuar organit administrativ pa plotësuar detyrimin ligjor të kryerjes së pagesës së detyrimit.

5. Me vendimin e datës 8.2.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesës së ngritur nga Avokati i Shtetit dhe palët e paditura, Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për nxjerrjen e çështjes administrative jashtë juridiksionit gjyqësor*”. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë pala e paditur DRT-ja dhe Avokatura e Shtetit.

6. Me vendimin nr. 00-2016-2904, datë 30.3.2016, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur: “*Prishjen e vendimit (i panumërtuar), datë 8.2.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nxjerrjen e çështjes gjyqësore administrative nr. 6848/420 (31010-07196-80-2015) Regj. Themeltar, jashtë juridiksionit gjyqësor*”.

II

7. **Kërkuesja, shoqëria “Vodafone Albania” sh.a.**, i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

7.1. *Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë*, pasi, duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, Gjykata e Lartë i ka mohuar kërkueses

gjykimin në themel të pretendimeve të saj. Sipas dispozitave ligjore në fuqi, detyrimi i tatimpaguesit për të bërë ankim në organet tatimore është pagimi paraprak i detyrimit kryesor dhe kamatëvonesave. Përcaktimi i detyrimit është një tagër i organeve tatimore dhe, për rrjedhojë, ligji i referohet shumës së përcaktuar nga tatimet. Por, nga ana tjetër, përlllogaritja e kamatëvonesës nuk është një çështje subjektive e organeve tatimore, por një çështje objektive, që del nga një përlllogaritje matematikore, që bëhet edhe nga vetë subjekti tatimor. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me të drejtë nuk e ka marrë të mirëqenë pretendimin e palës së paditur dhe ka caktuar një ekspert kontabël për të arritur në përfundimin nëse kërkuesja ka paguar shumën e pretenduar. Sipas këtij akti rezulton se shuma që pretendohet si detyrim bazuar në të dhënat e sistemit është fiktive, dhe verbalisht nga pala e paditur është pranuar se ky problem ka lindur edhe për subjekte të tjera. Por në të kundërt me arsyetimin e gjykatës së faktit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kamatëvonesa e detyrimit kryesor duhet të parapaguhet në shumën e përlllogaritur nga organet tatimore, pavarësisht nëse llogaritja është e drejtë apo e gabuar.

7.2. Gjykata e Lartë ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor edhe për kërkimin që ka si shkak të padisë pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, ndërkohë që sipas nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative, në të gjitha rastet kur pretendohet pavlefshmëria absolute e aktit, gjykata ka juridiksion për shqyrtimin e çështjes. Në këto raste gjykatat janë të detyruara të shqyrtojnë çështjen dhe nuk mund ta refuzojnë atë me arsyetimin se nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë të paktën duhej të kishte urdhëruar Gjykatën Administrative që të vazhdonte shqyrtimin e çështjes për padinë me kërkesë dhe shkak ligjor pavlefshmërinë e akteve administrative.

7.3. *Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*. Neni 9 i ligjit nr. 49/2012 i ka dhënë të drejtë Gjykatës së Lartë që të vendosë për prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit kur ato vendosin nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, por nuk i kanë dhënë të drejtë për



të kundërtën, pra për të prishur vendimet e faktit kur e kanë vlerësuar çështjen brenda juridiksionit. Sipas paragrafit të dytë të nenit 9, gjykata që vlerëson çështjen e juridiksionit duhet ta ketë çështjen në shqyrtim në themel. Po sipas kësaj dispozite, vendimi kundër të cilit mund të bëhet ankimi i veçantë është vendimi i nxjerrjes së çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Paragrafi i tretë i nenit 9 parashikon vendimin e Gjykatës së Lartë kur konstaton se çështja është brenda juridiksionit, por nuk ka asnjë parashikim për rastet kur Gjykata e Lartë konstaton se çështja është jashtë juridiksionit. Pranimi i ankimit të veçantë edhe në rastet kur gjykatat e faktit vlerësojnë se çështja është brenda juridiksionit gjyqësor bie në kundërshtim me rolin dhe natyrën e Gjykatës së Lartë, e cila shqyrton në shkallë të tretë çështjet për moszbatimin e ligjit ose shkelje të rënda procedurale. Përjashtimisht, Gjykata e Lartë ndërhyt, jashtë funksionit të saj të zakonshëm, për të mbrojtur të drejtat themelore procedurale të palëve në procesin gjyqësor. Në këtë kuptim, ndërhyrja e Gjykatës së Lartë nuk është e domosdoshme dhe nuk përligjet kur gjykata e faktit vlerëson se çështja duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor. Në përfundim, Gjykata e Lartë nuk duhet të pranonte gjykimin e ankimit të veçantë, por duhet të urdhëronte gjykatën administrative të vazhdonte gjykimin e themelit të çështjes.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesses

8. Kërkuessa legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, në kuptim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 30.3.2016, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë me postë në datën 28.2.2017, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar të zbatueshëm sipas ligjit organik të Gjykatës deri në datën 1 mars, kur kanë hyrë në fuqi ndryshimet e reja ligjore në lidhje edhe me afatin e paraqitjes së ankimit individual.

9. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, neni 131/1/f i Kushtetutës parashikon se individit mund

t’i drejtohet asaj për gjykimin përfundimtar të pretendimeve për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi nënkupton se kërkuessi duhet t’i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 17, datë 16.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Objekt kërkesë në rastin konkret është një vendim i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur përfundimisht nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Në kushtet kur ky vendim është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim nga gjykatat, kërkuessa nuk ka mjet tjetër ligjor për të goditur këtë vendim. Po ashtu, pretendimet e ngritura në kërkesë janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Për rrjedhojë, kërkuessa legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës në kuptim të nenit 131/1/f të Kushtetutës.

B. Lidhur me themelin e çështjes

B.1. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të së drejtës së aksesit në gjykatë

10. Sipas kërkuesses, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit, pasi duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor i ka mohuar kërkuesses gjykimin në themel të pretendimeve të saj. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me të drejtë nuk e ka marrë të mirëqenë pretendimin e palës së paditur dhe ka caktuar një ekspert kontabël për të arritur në përfundimin nëse kërkuessa ka paguar shumën e pretenduar dhe sipas këtij akti shuma që pretendohet si detyrim bazuar në të dhënat e sistemit është fiktive. Por në të kundërt me arsyetimin e gjykatës së faktit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kamatëvonesa e detyrimit kryesor duhet të parapaguhet në shumën e përlllogaritur nga organet tatimore, pavarësisht nëse llogaritja është e drejtë apo e gabuar. Po ashtu, sipas kërkuesses, neni 9 i ligjit



nr. 49/2012 i ka dhënë të drejtë Gjykatës së Lartë që të vendosë për prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit kur ato vendosin nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, por nuk i kanë dhënë të drejtë për të kundërtën, pra për të prishur vendimet e faktit kur e kanë vlerësuar çështjen brenda juridiksionit. Në zbatim të kësaj dispozite, Gjykata e Lartë nuk duhet të pranonte gjykimin e ankimit të veçantë, por të urdhëronte Gjykatën Administrative të vazhdonte gjykimin e themelit të çështjes.

11. Gjykata ka theksuar se bazuar në parimin *jura novit curia* ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që i është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimet nr. 27, datë 9.5.2012; nr. 50, datë 9.5.2012; nr. 19, datë 25.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pretendimet e kërkueses, edhe pse janë paraqitur veçmas prej saj, duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

12. Gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata ka theksuar se termi “*gjykatë*” karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.03.2009; nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 16, datë 27.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të

ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit. Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjyqtarit të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Bazuar në standardet e mësipërme dhe në rrethanat e çështjes konkrete në shqyrtim rezulton se kërkuësja i është drejtuar gjykatës administrative për shfuqizimin e akteve administrative në lidhje me detyrimet tatimore për vlerën e TVSH-së (përfshirë detyrimin, gjoba dhe interesa) dhe vendimit të organit administrativ që ka refuzuar ankimin administrativ. Në gjykim pala e paditur në proces ka pretenduar se kërkuësja nuk ka parapaguar detyrimet sipas parashikimeve ligjore dhe për këtë arsye ankimi administrativ nuk është marrë në shqyrtim. Për rrjedhojë është kërkuar edhe nga gjykata nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, për sa kohë që nuk është shteruar rruga administrative. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e ka rrëzuar këtë kërkim, duke arsyetuar se në rastin konkret nga provat e paraqitura nga palët dhe akti i ekspertimit kontabël rezulton se shoqëria paditëse ka paguar të gjithë detyrimin dhe kamatëvonesat që lidheshin me shumën e plotë. Sipas saj, kërkuësja i është nënshtruar edhe më parë një kontrolli tatimor, nga i cili kanë



rezultuar detyrimet dhe gjordat që ajo duhej të paguante. Pasi ka shlyer detyrimet, shoqëria ka paraqitur ankim administrativ, në përfundim të të cilit DAT-ja ka vendosur shfuqizimin e detyrimit shtesë për periudhën dhjetor 2011 dhe ka kërkuar kryerjen e rikontrollit tatimor për këtë periudhë. Në përfundim të rikontrollit (që i përket çështjes në shqyrtim) rezulton se për kërkuesen janë vendosur detyrime tatimore më të ulëta në krahasim me kontrollin e mëparshëm, të cilat shoqëria i kishte të kompensuara dhe për këtë ka paraqitur në gjykim një shkresë nga Drejtoria Tatimore Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, se nuk ka pasur detyrime të papaguara. Kjo rezulton të jetë konfirmuar edhe nga ekspertit i thirrur nga gjykata dhe sipas aktit të ekspertimit rezulton se është kryer pagesa e të gjitha detyrimeve dhe kamatëpagesave për qëllime të ankimit administrativ.

15. Vendimi për rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor është kundërshtuar nga pala e paditur në Gjykatën e Lartë. Kolegji Administrativ, në kundërshtim me qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, ka arsyetuar se ankimi administrativ nuk është ezauruar nga kërkuesja për faj të saj, sepse ka pasur dijeni lidhur me vlerësimin tatimor dhe kamatëvonesat, si dhe nuk rezulton të ketë kundërshtuar faktin e marrjes dijeni për urdhërpagesën që u përket këtyre të fundit. Po ashtu, ajo arsyeton: *“Gjykata administrative pranon sa nga përmbajtja e shkrësave dhe urdhërpagesave përkatëse të lëshuara nga sistemi informatik tatimor, pala paditëse nuk ka shlyer shumën... për sa i përket kamatëvonesave sikurse rezulton nga urdhërpagesa... Por, nga ana tjetër, kjo gjykatë thjesht arsyeton se në rastin në gjykim nga provat e paraqitura nga palët dhe akti i ekspertimit kontabël, shoqëria paditëse rezulton të ketë paguar detyrimet tatimore, por pa treguar se përse nuk është shlyer edhe shuma që u përket kamatëvonesave, sikurse rezulton nga urdhërpagesa e administruar dhe pranuar si provë nga vetë gjykata”*.

16. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në kundërshtim me funksionin e saj si gjykatë e ligjit, si dhe me standardet e vendosura prej saj, ka bërë një vlerësim të ndryshëm të provave të administruara gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë. Në këtë mënyrë, ajo ka dalë jashtë funksionit të saj ligjor, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

17. Lidhur me argumentin shtesë të kërkuesit, sipas të cilit Gjykata e Lartë nuk ka kompetenca të vendosë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, Gjykata çmon se ky pretendim është haptazi i pabazuar, pasi është në funksionin e saj të vendosë për të gjitha çështjet që lidhen me kompetencën dhe juridiksionin.

18. Lidhur me pretendimin se Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e aksesit në gjykatë kur ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor edhe për kërkimin që ka si shkak të padisë pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, Gjykata çmon se ky pretendim është bazuar.

19. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushtdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata vlerëson se në rastin konkret Gjykata e Lartë, referuar objektit dhe shkakut të padisë, si dhe pretendimeve të kërkuesit, ishte e detyruar të merrte në shqyrtim e të verifikonte nëse akti administrativ ishte ose jo absolutisht i pavlefshëm dhe nuk mund të refuzonte shqyrtimin



e çështjes me arsyetimin se çështja nuk ishte shqyrtuar në themel nga organi administrativ dhe se pala paditëse nuk kishte respektuar kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2016-2904, datë 30.3.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 57, datë 25.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 15.6.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 28 Akti, që i përket:

KËRKUES: Tahir Kurti

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë

Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë

Faqe | 7322

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 5041, datë 13.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1136, datë 11.5.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2015-299, datë 12.2.2015, të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, Tahir Kurti, që kërko i pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që kërko i rrëzimin e kërkesës, si dhe diskuto i çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka qenë efektiv në repartin ushtarak nr. 9910, Berat, deri në datën 28.3.1994. Me urdhrin nr. 751, datë 28.3.1994, kërkuesi ka dalë në rezervë. Sipas vërtetimit, për efekt të përfitimeve nga sigurimet suplementare, të lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, paga referuese e kërkuesit në momentin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës nga Forcat e Armatosura (FA) ka qenë 13.454 lekë. Kërkuesi ka pasur vjetërsi pune në FA për një periudhë prej 21 vjetësh e 8 muajsh. Nga përmbajtja e vendimit nr. 98, datë 13.6.2000, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Tiranë rezulton se kërkuesi, nga data 6.4.1999, është trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 8.610 lekë/muaj, llogaritur në bazë të pagës referuese dhe ligjit nr. 8087, datë 13. 3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura” (ligji nr. 8087/1996), të ndryshuar. Pas rritjeve të pësuar ndër vite, sipas VKM-ve përkatëse, masa e pensionit të kërkuesit, nga data 1.5.2009, ka qenë në masën 16.562 lekë.

2. Kërkuesi i është drejtuar gjykatës, duke pretenduar se DRSSH-ja Tiranë, në përcaktimin



e pensionit për vjetërsi shërbimi, nuk ka përmbushur detyrimet e caktuara nga nenet 11, gerrat “a” dhe “b” të ligjit nr. 8087/1996 dhe as ka bërë indeksimin e masës së pensionit, sipas VKM-ve përkatëse në vite.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5041, datë 13.6.2011, ka vendosur rrezimin e padisë së kërkuarit.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1136, datë 11.5.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 5041, datë 13.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-299, datë 12.2.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuarisi.

II

6. **Kërkuarisi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, ai ka parashtruar se:

6.1. Vendimet gjyqësore, objekt shqyrtimi, kanë cenuar nenin 42 të Kushtetutës për shkak të moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor. Gjykimi në Gjykatën e Lartë është realizuar për 2 vjet e 9 muaj nga shpallja e vendimit të gjykatës së apelit, pra jashtë afatit 90-ditor të përcaktuar në ligjin nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (ligji nr. 49/2012), të ndryshuar.

6.2. Është cenuar e drejta për përfitimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, pasi zgjidhja e mosmarrëveshjes nuk është kryer në përputhje me ligjin në fuqi në çastin e lindjes së të drejtës. Gjykatat me vendimet e tyre i kanë cenuar kërkuarisi të drejtën e ndihmës të parashikuar në nenin 52 të Kushtetutës dhe nuk kanë respektuar nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, si dhe hierarkinë e burimeve të së drejtës.

6.3. Gjykatat kanë cenuar parimin e sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e fituar për pension të parakohshëm, duke zvogëluar masën e pensionit në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese për ligjin “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve”. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë marrë parasysh vendime të ngjashme

gjyqësore për trajtimin e ushtarakëve me pension të parakohshëm, të cilat përbëjnë gjë të gjykuar.

6.4. Është cenuar e drejta e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, e garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi kërkuarisi, ndryshe nga kolegët e tjerë të tij, nuk ka përfituar nga indeksimi i pensionit dhe Gjykata e Lartë në rastin e tij nuk ka respektuar nenet 11 dhe 18 të ligjit nr. 8087/1996 për llogaritjen e masës së pensionit.

7. **Subjekti i interesuar**, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ka prapësuar si vijon:

7.1. DRSSH-ja Berat, së cilës i është drejtuar kërkuarisi për përfitimin e pensionit të parakohshëm, e ka llogaritur masën e pensionit konform ligjit nr. 8087/1996, si dhe indeksimeve të përcaktuara në VKM-të përkatëse. Pretendimi i kërkuarisi se në llogaritjen e masës së pensionit që i takon nuk është zbatuar ligji në fuqi në çastin e lindjes së të drejtës, nuk qëndron.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarisi

8. Gjykata vëren se kërkuarisi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë brenda afatit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, në jurisprudencën e saj konstante Gjykata ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit apo interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të



sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 4, datë 5.2.2014; nr. 1, datë 20.1.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kërkuesi ka pretenduar keqzbatimin e ligjit material nga gjykatat e zakonshme. Sipas tij, zgjidhja e mosmarrëveshjes nuk është kryer në përputhje me ligjin në fuqi në çastin e lindjes së të drejtës. Gjykatat me vendimet e tyre i kanë cenuar kërkuesit të drejtën e ndihmës të parashikuar në nenin 52 të Kushtetutës, nuk kanë respektuar nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe hierarkinë e burimeve të së drejtës. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë marrë parasysh vendime të ngjashme gjyqësore për trajtimin me pension të parakohshëm që përbëjnë gjë të gjykuar. Gjykata vlerëson se këto pretendime të kërkuesit kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme dhe si të tilla nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata.

11. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se është cenuar e drejta e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, e garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi ai nuk ka përfituar nga indeksimi i pensionit sipas VKM-ve përkatëse dhe as nga shtesa prej 2% për çdo vit vjetërsi mbi 15 vjet. Gjykata e Lartë, sipas tij, nuk ka respektuar nenet 11 dhe 18 të ligjit nr. 8087/1996 për llogaritjen e masës së pensionit dhe nuk ka marrë parasysh raste analoge për përfitues të tjerë ushtarakë, të cilëve u është njohur rritje e pensionit. Edhe këto pretendime të kërkuesit, në vlerësimin e Gjykatës, kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit material nga ana e gjykatave të zakonshme, çka nuk hyn në juridiksionin kushtetues. Për rrjedhojë, këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata.

12. Sipas kërkuesit, gjykatat kanë cenuar parimin e sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e fituar për pension të parakohshëm, duke zvogëluar masën e pensionit në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese për ligjin “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve”. Gjykata ka theksuar se procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, që nënkupton se u takon palëve të parashitrojnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre. Është detyrë e palëve të shpjegojnë arsyet të cilat kanë

çuar, sipas këndvështrimit të tyre, në shkelje të Kushtetutës, dhe më konkretisht të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 42, datë 25.5.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi nuk ka arritur të sjellë argumente të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin e mësipërm për cenimin e parimit të sigurisë juridike, duke mos arritur ta ngrejë atë në nivel kushtetues. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me këtë pretendim.

13. Në lidhje me pretendimin për mosgjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshëm, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se, në bazë të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, individ legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, për shkak se legjislativi nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 14, datë 10.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm

14. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore, objekt shqyrtimi, kanë cenuar nenin 42 të Kushtetutës për shkak të moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor. Gjykimi në Gjykatën e Lartë është realizuar për 2 vjet e 9 muaj nga shpallja e vendimit të Gjykatës së Apelit, pra jashtë afatit 90-ditor të përcaktuar në ligjin nr. 49/2012, të ndryshuar. Sipas kërkuesit, çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 29.4.2010 dhe ka përfunduar pas 4 vjetësh e 9 muajsh.

15. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo



vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjithashtu, Gjykata, lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeja e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeja e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuarin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për të arritur në përfundimin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, Gjykata vlerëson se duhet të merret në analizë secili prej elementeve të sipërcituara.

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

17. Lidhur me periudhën e *kobës që duhet marrë në konsideratë*, nga materialet bashkëlidhur kërkesës dhe të dhënat në faqen zyrtare *web* të Gjykatës së Lartë rezulton se çështja në shqyrtim është regjistruar në atë gjykatë në datën 2.8.2012 dhe vendimi është marrë në datën 12.2.2015, pra pas 2 vjetësh e 6 muajsh nga regjistrimi. Për rrjedhojë, shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë rezulton të ketë zgjatur për një periudhë rreth 2 vjet e 6 muaj.

ii. Kompleksiteti i çështjes

18. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkrësore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 59, datë 16.9.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, gjykimi i të cilave parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012, i ndryshuar. Çështja në shqyrtim ka për objekt detyrimin e një organi (DRSSH, Tiranë) për të ndryshuar vendimin

e tij për përcaktimin e masës së pensionit të kërkuarit, për rrjedhojë ajo nuk paraqet kompleksitet që mund të justifikonte vonesa në shqyrtimin e saj nga Kolegji Administrativ, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuarit është me rëndësi në këtë kontekst.

iii. Interesi dhe sjellja e kërkuarit

20. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuarit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata çmon se kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv. Sjellja e autoriteteve

21. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen rregullimin e saj edhe në dispozitat procedurale civile, e konkretisht në nenin 4 të KPC-së, i cili thotë: “Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme”, dhe në nenin 171/a të KPC-së, që thotë: “Gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj” (*shih vendimin nr. 45, datë 19.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka konstatuar se neni 3 i ligjit nr. 49/2012 ndër parimet e gjykimit administrativ ka përcaktuar garantimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Përderisa ligjvënësi ka përcaktuar këto afate kohore (90 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se ai i ka konsideruar ato si afate të arsyeshme për t'u zbatuar nga gjykatat



administrative. Në këtë drejtim, respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 59, datë 16.9.2016; nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se justifikimi në çështje të ngjashme se shkak i vonesës në shqyrtimin e çështjes është numri i lartë i çështjeve në ngarkim të këtyre gjykatave, nuk është i bazuar. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt, është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 59, datë 16.9.2016; nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit të interesuar se shtyrja në kohë e shqyrtimit të çështjes është bërë për shkak të ngarkesës së çështjeve, është i pabazuar.

24. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimin të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm, është i drejtë dhe duhet pranuar. Megjithëse zvarritja e procesit nuk përbën shkak për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, sipas objektit të kërkesës, fuqia detyruese e vendimit të Gjykatës shërben për parandalimin e zvarritjeve të proceseve gjyqësore nga ana e gjykatave. Gjykata nënvizon se nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehën qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë dhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues; ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare (*shih vendimin nr. 15, datë 10.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszhvillimit të gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimin të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshëm.

- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vitore Tusha

VENDIM

Nr. 58, datë 25.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 13.6.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 29 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Alb-Canaj” sh.p.k.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Shoqëria “Global Enterprise Group” sh.p.k.
Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2015-1766 (132), datë 3.3.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.



BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, shoqërisë “Alb-Canaj” sh.p.k., që kërkoji pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, shoqërisë “Global Enterprise Group” sh.p.k. dhe Avokaturës së Shtetit, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësja është person juridik që ushtron veprimtarinë e shfrytëzimit të mineralit të kromit sipas lejes minerare të shfrytëzimit nr. 481, datë 2.8.1999. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), sot Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI), pas kërkesës së bërë nga kërkuësja, ka vendosur me urdhrin e ministrit nr. 527, datë 16.7.2010, zgjerimin e lejes minerare të kërkueses dhe pasqyrimin e ndryshimit të sipërfaqes në regjistrin e lejeve minerare. Edhe subjekti i interesuar, shoqëria “Global Enterprise Group” sh.p.k., si person juridik i regjistruar, është pajisur me lejen minerare të shfrytëzimit nr. 1497, datë 10.9.2010. Nga një studim i kryer nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ka rezultuar një mbivendosje e sipërfaqeve të dhëna për shfrytëzim kërkueses dhe subjektit të interesuar, shoqërisë “Global Enterprise Group” sh.p.k.

2. METE-ja, me urdhrin nr. 1003, datë 13.12.2011, ka ndryshuar sipërfaqen e lejes minerare që i është dhënë kërkueses duke e zgjeruar atë, ndërsa me urdhrin nr. 1004, datë 13.12.2011, ka revokuar lejen minerare të shfrytëzimit dhënë subjektit të interesuar, shoqërisë “Global Enterprise Group” sh.p.k. Këta dy urdhra janë kundërshtuar në gjykatë nga subjekti i interesuar, shoqëria “Global Enterprise Group” sh.p.k. Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Tiranë, me vendimin nr. 6505, datë 11.6.2013, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes për mosparaqitje në gjykim të paditësit. Ky vendim është ankimuar nga kërkuësja në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. 162, datë 27.3.2014, ka vendosur mosshqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e saj për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Me vendimin nr. 3321, datë 9.9.2014, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pushimin e gjykimit.

3. Në vijim, METE-ja, me urdhrin nr. 589, datë 21.6.2013, ka revokuar urdhrin nr. 1003, datë 13.12.2011, dhe me urdhrin nr. 590, datë 21.6.2013, ka shfuqizuar urdhrin nr. 1004, datë 13.12.2011. Këta urdhra janë bazuar në raportkontrollin e Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion (DKBAA) nr. 165, datë 16.5.2013.

4. Kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi duke kërkuar anulimin e urdhrave nr. 589/2013 dhe nr. 590/2013 të METE-s, detyrimin e MEI-t të zbatojë urdhrat nr. 1003/2011 dhe nr. 1004/2011, si dhe sigurimin e padisë nëpërmjet pezullimit të zbatimit të urdhrave nr. 589/2013 dhe nr. 590/2013.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1763, datë 21.4.2014, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të urdhrave nr. 589 dhe nr. 590 të datës 21.6.2013, detyrimin e MEI-t të zbatojë urdhrat nr. 1003/2011 dhe nr. 1004/2011, si dhe rrëzimin e kërkesës për marrjen e sigurisë së padisë.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3094, datë 16.7.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1763, datë 21.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

7. MEI ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1763, datë 21.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 289, datë 11.9.2014.

8. Me vendimin nr. 00-2015-1766 (132), datë 3.3.2015, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (KAGJL) ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1763, datë 21.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe



vendimit nr. 3094, datë 16.7.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe rrëzimin e padisë.

II

9. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

9.1. Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj nga KAGJL-ja, pasi vendimi nuk është mbështetur në provat e administruara gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në apel. Ky Kolegj ka tejkualuar kufijtë e kërkesave të parashtruara nga palët, në shkelje të parimit të disponibilitetit dhe në kundërshtim me parimet mbi të cilat mbështetet procesi gjyqësor civil dhe administrativ. Sipas kërkueses, procedura e konkurrimit për marrjen e lejes minerare, së cilës i është referuar në vendim KAGJL-ja, nuk përmendet fare si provë e administruar gjatë gjykimeve në shkallët më të ulëta. Po kështu, kërkuesja pretendon se kur ministri ka nxjerrë urdhrat nr. 589/2013 dhe nr. 590/2013, çështja ka qenë në proces shqyrtimi në Gjykatën e Apelit dhe asnjë organ i administratës nuk kishte të drejtë të shqyrtonte një mosmarrëveshje civile që ishte duke u shqyrtuar nga gjykata, bazuar në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

9.2. Është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, për shkak se vendimi i KAGJL-së është i paqartë dhe jologjik. KAGJL-ja nuk ka zbatuar dispozitat ligjore që ishin në fuqi në kohën kur janë nxjerrë lejet minerare për kërkuesen dhe subjektin e interesuar, “Global Enterprise Group” sh.p.k. Ajo ka mbajtur qëndrime kontradiktore, pa përmendur dispozitat ligjore ku referon paligjshmërinë e akteve administrative për të cilat shprehet në vendim.

10. **Subjekti i interesuar**, MEI, pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesja nuk përmban elemente të cenimit të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

10.1. Vendimi i KAGJL-së është i mbështetur tërësisht në provat e administruara në dosjen gjyqësore dhe përbën një vendim të drejtë e të mbështetur në ligj. Ky Kolegj është shprehur për të gjitha kërkimet e parashtruara nga kërkuesja dhe e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Me të drejtë,

Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se aktet administrative, objekt i gjykimit të themelit, janë akte të nxjerra konform ligjit nga organi kompetent administrativ.

10.2. Neni 36 i KPC-së nuk është shkelur, pasi në kohën kur janë nxjerrë urdhrat objekt i gjykimit të themelit, çështja që pretendon kërkuesja ishte pushuar për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse. Pretendimi i kërkueses se KAGJL-ja ka keqinterpretuar nenin 36 të KPC-së, nuk është i bazuar.

11. **Subjekti i interesuar**, shoqëria “Global Enterprise Group” sh.p.k., ka prapësuar si vijon:

11.1. KAGJL-ja ka dhënë një vendim të drejtë në harmoni me të gjitha provat shkresore, pretendimet dhe prapësimet e palëve ndërgjyqëse. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, çështja civile ishte pushuar nga gjykata 10 ditë përpara se MEI të nxirrte aktet administrative, përkatësisht urdhrat nr. 589/2013 dhe nr. 590/2013. Këto dy akte janë nxjerrë nga organi kompetent bazuar në ligj dhe në prova shkresore.

11.2. Në çështjen konkrete, KAGJL-ja është shprehur për të gjitha kërkimet e parashtruara nga kërkuesja në respektim të neneve 6 dhe 28 të KPC-së. Pretendimi i kërkueses se Gjykata e Lartë ka keqinterpretuar nenin 36 të KPC-së, nuk është i bazuar.

12. **Subjekti i interesuar**, Avokatura e Shtetit, ka parashtruar si më poshtë:

12.1. Pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj nuk është i bazuar. KAGJL-ja nuk ka administruar prova të reja dhe nuk ka bërë rivlerësim të provave ekzistuese. Ky kolegj ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore, në referim të dispozitave përkatëse procedurale dhe atyre të ligjit nr. 49/2012.

12.2. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, vendimi i Gjykatës së Lartë i ka përmbushur standardet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese në lidhje me parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Ai përmban të gjitha elementet që duhet të ketë një vendim gjyqësor i arsytuar.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuases

13. Gjykata vëren se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 50/4 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, vërehet se kërkuësja ka ngritur pretendime të cilat *prima facie* lidhen me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në vijim janë shqyrtuar sipas radhës së mësipërme pretendimet e kërkuases.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe parimit të disponibilitetit në gjykim

15. Kërkuësja ka pretenduar se KAGJL-ja ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, pasi vendimi nuk është mbështetur në provat e administruara gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në apel. Sipas saj, procedura e konkurrimit për marrjen e lejes minerare, së cilës i është referuar në vendim KAGJL-ja, nuk përmendet fare si provë e administruar gjatë gjykimeve në shkallët më të ulëta. Po ashtu, KAGJL-ja ka tejkuluar kufijtë e kërkesave të parashtruara nga palët, në shkelje të parimit të disponibilitetit dhe në kundërshtim me parimet mbi të cilat mbështetet procesi gjyqësor civil dhe administrativ. Po sipas saj, ministri nuk kishte të drejtë të nxirrte urdhrat nr. 589/2013 dhe nr. 590/2013, pasi urdhrat e mëparshëm nr. 1003/2011 dhe nr. 1004/2011 ishin në proces shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Apelit dhe asnjë organ i administratës nuk kishte të drejtë të shqyrtonte një mosmarrëveshje civile që ishte duke u shqyrtuar nga gjykata, bazuar në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

16. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto

organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 40, datë 25.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale, të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në nocionin kushtetues të rishikimit futet, në radhë të parë, shqyrtimi i rekurseve për pretendimet e shkeljes të ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 11, datë 3.3.2016; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 31, datë 1.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Sipas jurisprudencës kushtetuese, procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtësi të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat e faktit. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt. Gjykata ka theksuar se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin



e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu referuar çështjes konkrete, Gjykata vëren se KAGJL-ja ka arsyetuar se “*vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Apelit janë marrë në zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit dhe si të tilla ato janë të cenueshme. Urdhrat nr. 589, datë 21.6.2013, dhe nr. 590, datë 21.6.2013, të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, janë akte administrative të nxjerra në bazë e për zbatim të ligjit, në përputhje me kompetencat ligjore që ligji i njej atij organi administrativ. Aktet administrative të kundërshtuara nga pala paditëse janë marrë në zbatim të nenit 102/4 të Kushtetutës, ligjit nr. 10304/2010 “Për sektorin minerar në RSH”, nenit 121 e vijues të K. Pr. Administrative, si dhe rekomandimeve të DKBAA, dërguar me raport kontrollin nr. 1657, datë 16.5.2013. Aktet 589 dhe 590, të cilat kundërshtohen nga paditësi, nuk janë akte absolutisht të pavlefshme, pasi janë nxjerrë nga organi kompetent në zbatim të ligjit dhe duke respektuar procedurën ligjore”.* Nga sa më sipër, Gjykata çmon se KAGJL-ja i ka analizuar dhe vlerësuar vendimet e gjykatave më të ulëta në vështrim të dispozitave ligjore të zbatueshme në çështjen konkrete, duke arritur në përfundimin se ato janë marrë në zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit. Nga vlerësimi në tërësi i vendimit objekt shqyrtimi, duke u bazuar në kompetencat që Gjykata e Lartë gëzon si gjykatë ligji, Gjykata nuk gjen elemente të cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

20. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të disponibilitetit, Gjykata rithekson se parimi i disponibilitetit është një parim i rëndësishëm procedural civil, i cili parashikohet në nenin 2 të Kodit të Procedurës Civile. Pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e këtij parimi janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e janë analizuar bashkërisht edhe në funksion të standardeve të tjera kushtetuese që karakterizojnë këtë të drejtë. E drejta për të disponuar mbi objektin e padisë është një e drejtë e paditësit, i cili e ushtron atë

duke bërë ndryshimet, shtesat apo pakësimet e objektit të padisë sipas interesave të tij. Gjykata nuk mund të diktojë objektin e padisë dhe as të pengojë paditësin në ushtrimin e së drejtës për të disponuar mbi këtë objekt (*shih vendimin nr. 6, datë 15.4.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka vlerësuar se një kërkues nuk legjitimohet *ratione personae* në ngritjen e pretendimit për cenimin e parimit të disponibilitetit në rast se objekti i gjykimit përcaktohej nga një palë tjetër (*shih vendimet nr. 16, datë 19.4.2013; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 6, datë 15.4.2005; nr. 20, datë 2.7.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se urdhrat nr. 1003/2011 dhe nr. 1004/2011, të nxjerra nga METE-ja, janë kundërshtuar në gjykatë nga subjekti i interesuar, shoqëria “Global Enterprise Group” sh.p.k. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6505, datë 11.6.2013, ka vendosur pushimin e gjykimit për mosparaqitje të paditësit, shoqërisë “Global Enterprise Group” sh.p.k. Në këtë proces kërkuesja ishte thirrur në cilësinë e personit të tretë. Vendimi i pushimit të gjykimit është ankimuar nga kërkuesja, e cila më pas ka hequr dorë nga ankimi i ushtruar prej vetë asaj. Mbi këto fakte, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3321, datë 9.9.2014, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Në këto rrethana, Gjykata çmon se pretendimet e kërkueses në lidhje me cenimin e parimit të disponibilitetit, si rrjedhojë e nxjerrjes së akteve administrative në shkelje të nenit 36 të KPC-së gjatë kohës që çështja ishte në shqyrtim gjyqësor, nuk argumentojnë cenimin e këtij standardi. Për më tepër, ato kanë të bëjnë me një proces gjyqësor, ku objekti i gjykimit përcaktohej nga një palë tjetër.

22. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese dhe nga aktet e administruara, në vlerësimin e Gjykatës nuk rezulton që KAGJL-ja të jetë shprehur tej objektit të padisë apo tej shkaqeve të paraqitura në rekursat e bëra nga palët në gjykim. Nisur nga ky konstatim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të disponibilitetit në gjykim është i papabazuar.

23. Nisur nga analiza dhe standardet kushtetuese të mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e parimit të



gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të parimit të disponibilitetit në gjykim janë të pabazuara dhe nuk duhen pranuar.

C) *Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

24. Kërkuësja ka pretenduar se është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i KAGJL-së është i paqartë dhe jologjik. KAGJL-ja nuk ka zbatuar dispozitat ligjore që ishin në fuqi në kohën kur janë nxjerrë lejet minerare për kërkuësen dhe subjektin e interesuar, “Global Enterprise Group” sh.p.k. Ajo ka mbajtur qëndrime kontradiktore në vendim, pa përmendur dispozitat ligjore ku referon paligjshmërinë e akteve administrative për të cilat shprehet në vendim. KAGJL-ja, megjithëse ka konkluduar se akti i zgjerimit të lejes minerare është i pavlefshëm, nuk përcakton nëse jemi përpara pavlefshmërisë absolute apo relative. Kolegji nuk ka mbajtur parasysh faktin se akti administrativ i revokimit është bërë jashtë afatit 3-vjeçar të parashikuar në KPA. Sipas kërkuëses, vendimi i KAGJL-së është jologjik, pasi i referohet një ligji që nuk ishte i zbatueshëm në rastin konkret.

25. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, si dhe nga neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar. Funkzioni i një vendimi të arsytuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe ju jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsytuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka vlerësuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e

mundur, duhet bërë arsytimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsytimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsytimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Duke iu kthyer çështjes konkrete, nga përmbajtja e vendimit të KAGJL-së nuk rezulton që ky vendim jetë jologjik, të ketë kundërthënë, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e trajtuara nga jurisprudenca kushtetuese e sipërcituar. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuëses për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është i pambështetur.



30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuases për cenim të procesit të rregullt ligjor janë të pabazuara dhe nuk duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Vitore Tusha

Anëtar kundër: Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 59, datë 28.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“
Gani Dizdari	anëtar	i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar	i	“	“
Fatos Lulo	anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 15.6.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 25 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Hamit Kapllani (Laçi), Hasan Tërbuni

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Xhevat Kuçi, Ministria e Financave, Avokatura e Shtetit, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e
Faqe | 7332

mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor.

Detyrimi i Ministrisë së Financave për të dëmshpërblyer kërkuessit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27 e vijuese, si dhe neni 71/ç i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuessve, që kërkuan pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Ministrisë së Financave dhe Avokaturës së Shtetit, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në vitin 1991, punonjësit e “Pallatit të Kulturës, Bar-Bufe”, Pukë, mes të cilëve dhe kërkuessi Hamit Kapllani, kanë marrë me qira lokalit dhe kanë privatizuar mjetet e xhiros e materiale të tjera në funksion të veprimtarisë private.

2. Agjencia Kombëtare e Privatizimit sipas shkresës nr. 761/1 Prot., datë 6.4.1994, ka autorizuar kalimin e pronësisë së objektit “Pallati i Kulturës, Bar-Bufe”, Pukë te kërkuessi Hamit Kapllani (Laçi). Me kontratën e shitjes së datës 7.4.1994, lidhur midis Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe kërkuessit është realizuar shitja e lokalit.

3. Agjencia Kombëtare e Privatizimit Tiranë, me shkresën nr. 21 Prot., datë 28.1.1997, e përcaktuar si “Autorizim për shitje truall”, ka autorizuar shitjen e truallit me sipërfaqe 122 m² kërkuessit Hamit Kapllani (Laçi). Me kontratën e shitjes së datës 28.1.1997, të lidhur midis Seksionit Ekonomik të Këshillit të Rrethit Pukë dhe kërkuessit Hamit Kapllani është realizuar shitja e truallit të lokalit me sipërfaqe 143.2 m², e cila është regjistruar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, duke kaluar pronësia në emër të kërkuessit Hamit Kapllani.



4. Me kontratën e shitjes nr. 20 rep., nr. 20 kol., datë 31.4.2000, kërkuesi Hamit Kapllani i ka shitur kërkuesit, Hasan Tërbunit, objektin “Pallati i Kulturës, Bar-Bufe”, Pukë.

5. Subjekti i interesuar Xhevat Kuçi dhe shtetasi N. Gj., në cilësinë e dy prej bashkëpronarëve të veprimtarisë së lokalit, në vitin 1994 kanë paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë kundër Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe NTSH-së Pukë, duke thirrur si person të tretë kërkuesin Hamit Kapllani, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik, kontratës së shitjes së datës 7.4.1994.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, me vendimin nr. 188, datë 13.5.1994, ka vendosur rrëzimin e padisë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1867, datë 5.8.1994, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë po asaj gjykate.

7. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, me vendimin nr. 44, datë 15.12.1994, ka vendosur rrëzimin e padisë, ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1139, datë 22.3.1995, përsëri ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe e ka dërguar çështjen për rigjykim.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, me vendimin nr. 219, datë 30.5.1995, ka vendosur rrëzimin e padisë, vendim i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 3389, datë 28.7.1995, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit ka dhënë për këtë çështje dy vendime të ndryshme me të njëjtin numër e datë, me po atë objekt, shkak dhe të njëjtat palë. Konkretisht me vendimin nr. 1440, datë 19.10.1995, Kolegji Civil ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3389, datë 28.7.1995, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Ndërsa me vendimin tjetër me të njëjtin numër e datë, të njëjtat palë e objekt, Kolegji Civil ka vendosur prishjen e vendimeve nr. 219, datë 30.5.1995, të Gjykatës së Rrethit Pukë dhe nr. 3389, datë 28.7.1995, të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Pukë.

10. Çështja është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila, me vendimin nr. 2690, datë 5.11.1996, ka vendosur pranimin e padisë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 767, datë 19.2.1997, ka vendosur lënien në fuqi të

vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 480, datë 9.04.1998, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

11. Ndërkohë, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Pukë, me vendimin nr. 83, datë 17.2.1997, u ka njohur shtetasve A. R., E. R., Sh. R., H. R., S. R. dhe E. R., si dhe trashëgimtarëve të tyre, si ish-pronarë, pronësinë e sipërfaqes prej 80.806 m², e ndodhur në qytetin e Pukës, me kufijtë përkatës, dhe kompensimin në vlerë për sipërfaqen prej 16.541 m².

12. Kërkuesi Hamit Kapllani i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimeve nr. 1440, datë 19.10.1995, dhe nr. 480, datë 9.4.1998, të Gjykatës së Kasacionit. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 76, datë 29.12.1998, ka vendosur shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 1440, datë 19.10.1995, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, pasi kishte dhënë dy vendime për të njëjtën çështje dhe të vendimit nr. 480, datë 9.4.1998, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, pasi Gjykata e Lartë e kishte shqyrtuar çështjen pa pasur dosjen.

13. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 407, datë 28.3.2000, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3389, datë 28.7.1995, të Gjykatës së Apelit Tiranë; të vendimit nr. 219, datë 30.5.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, të vendimit nr. 767, datë 19.2.1997, të Gjykatës së Apelit Tiranë, të vendimit nr. 2690, datë 5.11.1996, të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë Pukë me tjetër trup gjykues.

14. Për shkak të djegies së dosjes gjatë ngjarjeve të vitit 1997, rigjykimi ka filluar me kërkesëpadi të re, pas shqyrtimit të së cilës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, me vendimin nr. 141, datë 23.5.2002, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitblerjes së datës 7.4.1994, të lidhur mes AKP-së dhe kërkuesit Hamit Kapllanit për objektin “Pallati i Kulturës, Bar-Bufe”, Pukë dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

15. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 310, datë 12.11.2002, ka vendosur lënien në



fuqi të vendimit nr. 141, datë 23.5.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë për sa i përket konstatimit të pavlefshmërisë së kontratës së shitjes të datës 7.4.1994 dhe rregullimit të pasojave të saj, si dhe pushimin e gjykimit për pjesën tjetër.

16. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 592, datë 11.3.2004, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 310, datë 12.11.2002 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

17. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 108, datë 23.3.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 141, datë 23.5.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë me këtë ndryshim: detyrimin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit Dega Shkodër t'i paguajë kërkuessit Hamit Kapllani çmimin e blerjes së objektit "Pallati i Kulturës Bar-Bufë", Pukë sipas indeksit të vlerës së lekut. Deklarimin të pavlefshëm të veprimtimit juridik midis Hamit Kapllanit (Laçi) dhe Hasan Tërbunit, duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme.

18. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 852, datë 29.6.2006, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 108, datë 23.3.2005, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

19. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 451, datë 27.12.2006, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 141, datë 23.5.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

20. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-500 (155), datë 7.4.2011, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 451, datë 27.12.2006, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po asaj gjykate me tjetër trup gjykues.

21. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 514, datë 7.10.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 141, datë 23.5.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe pushimin e gjykimit, duke arsyetuar se padia e ngritur nga subjekti i interesuar Xhevat Kuçi nuk është e bazuar për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv. Gjithashtu, pas datës 28.3.2012, me vdekjen e trashëgimlënësit A. E., të pretenduar si njëri nga

subjektet bashkëpronare në sendin objekt gjykimi, subjekti i interesuar Xhevat Kuçi nuk ka legjitimitet aktiv për të përfaqësuar trashëgimlënësin, sepse nuk ka provuar gjatë procesit gjyqësor cilësinë e tij si trashëgimtar.

22. Mbi rekursin e paditësit Xhevat Kuçi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-1957 (368), datë 21.6.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 514, datë 7.10.2013, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

II

23. **Kërkuesit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e tejkzgjatjes së afatit të gjykimit të çështjes.

24. **Subjekti i interesuar, Ministria e Financave**, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

24.1 Kërkuesit nuk legjitimohen *ratione personae*, pasi nuk kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion përpara se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

24.2 Ata nuk kanë parashtruar asnjë pretendim në nivel kushtetues për të argumentuar pretendimin e tyre për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e zgjatjes së procesit gjyqësor.

24.3 Pretendimi i kërkuesve për të kërkuar shpërblimin e dëmit si pasojë e tejkzgjatjes së procesit gjyqësor është i pabazuar. Kërkimi për dëmshpërblim mund të pretendohet vetëm për gjykimet e zhvilluara para Gjykatës Kushtetuese dhe jo në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

25. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

25.1 Pretendimi i kërkuesve për tejkzgjatje të procesit gjyqësor është i pabazuar, pasi nuk kanë parashtruar asnjë argument kushtetues. Kërkesa për cenim të procesit të rregullt ligjor si pasojë e tejkzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të jetë e mbështetur në argumente kushtetuese dhe nuk mjafton paraqitja formale e argumenteve.

25.2 Kërkuesit nuk kanë provuar asnjë vonesë nga autoritetet. Nga tejkzgjatja e procesit gjyqësor atyre nuk u ka ardhur asnjë pasojë. Kronologjia e seancave gjyqësore ka provuar kompleksitetin e çështjes, e cila në çdo rast ka marrë drejtim në referim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë.



26. **Subjekti i interesuar, Xhevat Kuçi**, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

27. **Subjekti i interesuar, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike**, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

28. Gjykata vlerëson se kërkuësit legjitimohen *ratione personae* bazuar në nenet 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës. Për legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuësit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e tejkzgjatjes së afatit të gjykimit, si dhe bazuar në nenin 71/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, kanë kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga kjo tejkzgjatje.

29. Gjykata fillimisht vlerëson të shprehet për legjitimitimin e kërkuësve për kërkimin e shpërblimit të dëmit, si pasojë e tejkzgjatjes së afatit të gjykimit. Gjykata thekson se bazuar në nenin 71/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, kushdo që është palë në një proces që zhvillohet para Gjykatës Kushtetuese dhe pretendon se gjykimi është zhvilluar tej afatit të arsyeshëm, ka të drejtë të pretendojë shpërblim të drejtë nga Gjykata Kushtetuese, nëse konstatohet se nga kjo tejkzgjatje i janë cenuar të drejtat dhe liritë.

30. Gjykata konstaton se pretendimi i kërkuësve për shpërblimin e dëmit është i lidhur me cenimin e të drejtave dhe lirive si pasojë e tejkzgjatjes së shqyrtimit të çështjes nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe jo sipas parashikimit të nenit 71/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se kërkuësit nuk legjitimohen në kërkimin e tyre pasi ky pretendim hyn në juridiksionin e gjykatave të zakonshme.

31. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e tejkzgjatjes së afatit të gjykimit, Gjykata ka pranuar se kërkesat e individëve për cenimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm mund të merren në shqyrtim, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave

kushtetues dhe ligjorë të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 51, datë 20.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në të tilla gjykime, Gjykata shqyrton nëse ka pasur mjete, të cilat kërkuësi duhej t'i shfrytëzonte në plotësim të kushtit të shterimit të mjeteve. Në këtë drejtim, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, mjetet në dispozicion të një ndërgjyqësi për të parashtruar një ankesë për zgjatjen e procesit janë “efektive” në qoftë se ato “parandalojnë shkeljen e pretenduar, pengojnë vazhdimin e saj ose ofrojnë një riparim të përshtatshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur” (*shih vendimin nr. 56, datë 21.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se kërkuësit legjitimohen në kërkimin e tyre për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e gjykimit të çështjes tej një afati të arsyeshëm.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm

32. Kërkuësit kanë pretenduar se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për shkak të gjykimit të çështjes gjyqësore tej afateve ligjore.

33. Gjykata thekson se bazuar në nenin 42 të Kushtetutës kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në çështjen konkrete jemi para rastit kur gjykimi ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit. Gjykata pretendimet e kërkuësve lidhur me tejkzgjatjen e gjykimit i shqyrton nën dritën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, të reflektuara edhe në praktikën e saj, pra referuar rrethanave të veçanta të çështjes,



duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuarit kjo tejzgjatje.

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

35. Lidhur me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarve për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor lidhen me periudhën prej vitit 1994, kur ka filluar procesi gjyqësor deri në vitin 2016, kur çështja është gjykuar nga Gjykata e Lartë.

ii. Kompleksiteti i çështjes

36. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 15, datë 30.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Çështja ka pasur për objekt deklarinimin të pavlefshëm të aktit të shitblerjes të lidhur mes degës së AKP-së dhe Hamit Kapllani, me objekt “Pallati i Kulturës Bar-Bufë”, Pukë. Kjo çështje nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet, si nga pikëpamja faktike ashtu dhe ligjore, që do të justifikonte tejzgjatjen e procesit gjyqësor 23 vjet në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

iii. Interesi dhe sjellja e kërkuarve

38. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuarit kanë vepruar në përputhje me të drejtat e tyre procedurale, duke ndjekur të gjitha gjykimet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Ata kanë shfaqur interes të vazhdueshëm dhe nuk rezulton të jenë bërë shkak apo të kenë shkaktuar vonesa gjatë gjykimeve.

iv. Sjellja e autoriteteve

39. Gjykata konstaton se çështja në shqyrtim është gjykuar për një periudhë 23-vjeçare duke u kthyer disa herë për rigjykim. Konkretisht, çështja është gjykuar rreth pesë herë nga Gjykata e Rrethit, tetë herë nga Gjykata e Apelit dhe shtatë herë nga Gjykata e Lartë. Në përfundim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-1957, datë 21.6.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 514, datë 7.10.2013, të Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila

kishte vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Kolegji ka arsyetuar se prej datës 28.3.2012, me vdekjen e trashëgimlënësit A. K., në cilësinë e njërit prej bashkëpronarëve, trashëgimtari i tij Xhevat Kuçi, i cili është subjekt i interesuar në gjykimin kushtetues, nuk ka legjitimitet aktiv në ngritjen e padisë, pasi nuk ka provuar cilësinë e tij si trashëgimtar.

40. Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete jemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e zgjatjes së afatit të gjykimit 23 vjet në të gjitha shkallët e gjyqësorit. Gjykata çmon se ky gjykim është zhvilluar tej çdo afati të arsyeshëm nga sistemi gjyqësor dhe në veçanti nga Gjykata e Lartë, e cila si gjykatë ligji merr në shqyrtim vetëm rastet kur nuk është respektuar ose zbatuar keq ligji, si dhe kur ka shkelje të rënda të normave procedurale. Sikurse u parashtrua, kthimi i çështjes disa herë për rigjykim nga gjykatat, si dhe sjellja e Gjykatës e Lartë duke dhënë dy vendime të ndryshme me të njëjtin numër e datë, me po atë objekt, shkak dhe të njëjtat palë, si dhe duke shqyrtuar çështjen pa pasur dosjen, kanë ndikuar në zgjatjen e afatit të gjykimit të çështjes tej çdo afati të arsyeshëm.

41. Veprime të kësaj natyre sjellin pasoja negative jo vetëm tek qytetarët, por cenojnë dhe autoritetin e organeve gjyqësore duke ndikuar në efektivitetin e sistemit gjyqësor.

42. Në përfundim, Gjykata çmon se në rastin konkret jemi para konstatimit të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e zgjatjes së afatit të gjykimit, tej çdo afatit të arsyeshëm, për rrjedhojë kërkesa është e bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri.

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.



- Rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Antarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Fatmir Hoxha

VENDIM

Nr. 60, datë 31.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.7.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 32 Akti, që u përket:

KËRKUESE: Shoqata për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Punëve të Brendshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 35, 36 dhe 37 të Kushtetutës; nenet 49/3/d e në vijim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuësës, e cila kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Shqipërisë në datën 22.9.2016 ka miratuar ligjin nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare dhe ka hyrë në fuqi në datën 28 dhjetor 2016, 3 muaj pas botimit.

2. Ligji ka si qëllim krijimin e kushteve ligjore për sigurimin e bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit dhe subjekteve publike e private, veprimtaria e të cilave përbën burim rreziku të shtuar për sigurinë, me synim zbulimin, parandalimin dhe goditjen e çdo veprimtarie kriminale, në mbrojtje të pronës e të jetës, si dhe garantimin e sigurisë publike.

3. Kërkuesja është një organizatë e regjistruar me vendimin nr. 162, datë 23.1.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me veprimtari në mbrojtje të interesave të anëtarëve të saj, pra tregtarëve, si dhe në fushën e mbrojtjes së rregullave të tregut.

II

4. **Kërkuesja** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e të gjithë ligjit, sipas objektit, por në brendësi të kërkesës ajo paraqet pretendime për nenin 4, shkronjat ‘a’, ‘b’, ‘c’ dhe ‘ç’, si dhe nenet 7 dhe 8 të ligjit nr.19/2016. Pretendimet janë si më poshtë:

4.1. Ligji cenon veprimtarinë ekonomike, pasi me detyrimet që imponon, duke caktuar masa shtesë sigurie që përfshijnë përdorimin e sistemit të kamerave me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe etj., ndërhyrjen thellë në veprimtarinë ekonomike të subjekteve.

4.2. Ndërhyrja e ligjvënësit në veprimtarinë ekonomike nuk është proporcionale, pasi nuk ka një vlerësim real të rrezikut që i kanoset sigurisë, që të ketë çuar në marrjen e këtyre masave ekstreme. Kostot shtesë që u lindin anëtarëve të shoqatës janë të pajustificuara dhe ekstreme.

4.3. Ligjvënësi nuk mund të ndërmarrë politika penale duke përfshirë subjekte të së drejtës private, pasi ato mbeten domain i shtetit. Gjithashtu, shteti duhet të zgjedhë masa ndërhyrëse me karakter progresiv dhe jo ekstrem, kur nuk ka një studim ose analizë të qartë të rrethanave që kanë çuar në rritjen e kriminalitetit.

4.4. Ligji cenon jetën private, pasi individët vëzhgohen gjatë gjithë kohës nëse ata kalojnë ose



hyjnë në ambientet ku ushtrohet aktivitet tregtar. Gjithashtu, ligji nuk parashikon asnjë mundësi për ruajtjen e të dhënave private që grumbullohen ose përdoren nga autoritetet.

4.5 Ligji duhet pezulluar deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate, pasi sjell pasoja të pariparueshme.

5. Subjekti i interesuar, Kuvendi, parashtrori si më poshtë:

5.1. Kërkuesja nuk legjitimohet të kundërshtojë ligjin objekt kërkesë, sepse nuk argumenton lidhjen midis pasojave të ligjit dhe aktivitetit të tij, duke mos justifikuar interesin e cenuar, sipas saj, në mënyrë direkte, të sigurt dhe të dukshme. Vetëm pretendimi i ngritur se ligji mund të ketë efekt në të ardhmen, nuk është i mjaftueshëm për të legjitimuar kërkuesen.

5.2. Ligji objekt shqyrtimi nuk ka për qëllim rregullimin e ndonjë veprimtarie ekonomike apo tregtare, por të marrë masa për rritjen e sigurisë publike. Në këtë kontekst, vetëm fakti se disa subjekte tregtare duhet të marrin masa në zbatim të këtij ligji, nuk mund të konsiderohet si ndërhyrje në lirinë ekonomike të subjekteve tregtare.

5.3. Ligji ka parashikuar disa kriteret në bazë të të cilave Policia e Shtetit, në bashkëpunim edhe me subjekte të tjera publike ose private, do të zbatojë masat konkrete që parashikohen nga ligji. Asnjë nga këto masa nuk rezulton e tillë që të ketë pasoja të dëmshme për aktivitetin ekonomik të subjekteve tregtare. Ato kanë për qëllim rritjen e masës së mbrojtjes nga vepra penale të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e shtetasve. Edhe sikur të prezumohej apriori se mund të kishte ndonjë ndërhyrje në aktivitetin tregtar, ajo është tërësisht në përputhje me kriteret e parashikuara nga neni 17 i Kushtetutës, pra është për një interes publik dhe proporcional, pasi ndërhyrja është bërë me mjete legjitime, të arsyeshme dhe nuk tejkalon kufijtë e vendosur nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja.

5.4. Gjithashtu, është i pabazuar edhe pretendimi se ligji cenon të drejtën e privatësisë. Së pari, kërkuesja nuk legjitimohet për këtë kërkim, pasi e drejta për jetë private nuk bën pjesë në kategorinë e të drejtave që mund të kërkojnë prej këtij subjekti, pasi ka karakter tërësisht privat dhe individual. Së dyti, ligji parashikon procedura të plota lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave

personale, si element i së drejtës për jetë private. Ligji respekton raportin proporcional dhe balancues midis jetës private e të dhënave personale në raport me garantimin e sigurisë publike, raport i cili garanton respektimin e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore që gëzojnë të drejtat individuale.

5.5. Nuk duhet pranuar as kërkesa për pezullim të ligjit, pasi kërkuesja nuk ka sjellë asnjë argument lidhur me pasojat e dëmshme dhe të pariparueshme që mund të vijnë nga zbatimi i ligjit objekt shqyrtimi.

6. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, parashtron si më poshtë:

6.1. Kërkuesja nuk legjitimohet të kundërshtojë këtë ligj, pasi nuk justifikon interesin. Ligji ka për qëllim marrjen e masave të sigurisë publike në rastet kur vlerësohet se ka rrezik të shtuar dhe nuk ka për qëllim të rregullojë apo të ndërhyjë në veprimtarinë e lirë ekonomike të subjekteve private.

6.2. Nuk qëndron pretendimi i kërkueses se ligji cenon lirinë ekonomike, pasi qëllimi i këtij ligji është që të rritet siguria edhe për subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike, duke i mbrojtur ato nga situata të mundshme rreziku.

6.3. Nuk qëndron pretendimi se ligji cenon pronën e subjekteve tregtare, pasi ato duhet të vendosin me shpenzimet e tyre aparaturat e nevojshme, me qëllim mbrojtjen e sigurisë publike. Vetëm fakti që subjektet tregtare duhet të blejnë dhe instalojnë sistemin e sigurisë nuk është argument i mjaftueshëm për të kundërshtuar këtë ligj, që ka për qëllim mbrojtje të përgjithshme dhe pa dallim të të gjithë shtetasve. Është detyrë parësore e shtetit të sigurojë jetën, shëndetin dhe pasurinë e shtetasve dhe të subjekteve të tjera juridike, kur ka arsye të mjaftueshme të besojë se duhen shtuar masat e sigurisë publike.

6.4. Kërkuesja nuk legjitimohet të kundërshtojë ligjin edhe në kontekst të mbrojtjes së privatësisë dhe të të drejtave e lirive të tjera, pasi nuk argumenton se sa është numri i subjekteve që preken sipas saj dhe në çfarë mase. Gjithashtu, e drejta për privatësi e shtetasve në përgjithësi nuk mund të ngrihet nga kërkuesja, pasi ajo nuk përfaqëson të gjithë shtetasit, madje as nuk e ka në statut një gjë të tillë si objektiv.



6.5. Gjithashtu edhe kërkesa për pezullimin e ligjit nuk qëndron, pasi kërkesja nuk ka sjellë asnjë argument që të justifikojë nevojën për të pezulluar efektet e ligjit objekt kërkesë si, për shembull, pasojat e dëmshme dhe të pariparueshme që mund t'i vijnë kërkeses nga veprimi i ligjit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkeses

7. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*), Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134/2 të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkët. Ato, në cilësinë e “organizatave”, janë të specifikuar në nenin 134/1/h të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*shih vendimin nr. 78, datë 22.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata ka theksuar se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo interes bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Kërkesja legjitimohet *ratione personae* në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134/1/h i Kushtetutës dhe neni 49/3/d i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Ajo është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 162, datë 23.1.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për rrjedhojë gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit.

10. Po ashtu, kërkesja legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa për shfuqizimin e normave ligjore është paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 50/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se sipas statutit të shoqatës ajo mbron dhe përfaqëson interesat e anëtarëve të saj, pra tregtarëve, si dhe ka për qëllim të veprimtarisë së saj ofrimin e shërbimeve dhe dhënien e kontributit për organizimin e aktiviteteve për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të anëtarëve të shoqatës, si dhe të tregtisë së ligjshme në vend. Ky subjekt ka pretenduar para Gjykatës se ligji nr. 19/2016 cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike të anëtarëve të saj dhe të drejtën e privatësisë. Gjykata, për sa më sipër, vlerëson se lidhur me pretendimin për cenim të lirisë ekonomike kërkesja legjitimohet edhe *ratione materiae* për iniciimin e kontrollit kushtetues të ligjit objekt kërkesë. Ndërsa për sa i takon pretendimit për cenim të privatësisë, ajo nuk legjitimohet, pasi kjo është një e drejtë që mund të mbrohet gjyqësisht vetëm nga personat e prekur drejtpërdrejt dhe jo nga të tretët.

B. Për kërkesën për pezullimin e ligjit

12. Kërkesja ka kërkuar para Gjykatës edhe pezullimin e ligjit objekt kërkesë, por nuk e ka shoqëruar këtë kërkim me argumente konkrete lidhur me pasojat e rënda dhe të pariparueshme që i vijnë nga zbatimi i mëtejshëm i ligjit.

13. Gjykata, në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka kompetencë të vlerësojë nëse zbatimi i normës konkrete mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas rastit, çka përbën kriterin thelbësor për pezullimin e ekzekutimit të kësaj norme. Gjykata vlerëson se në kuptim të dispozitës së sipërcituar,



kërkuesja nuk paraqiti argumente në lidhje me pasojat e rënda apo të pariparueshme që sjell zbatimi i ligjit të kundërshtuar. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve, në datën 13.6.2017, vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim si të pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të lirisë ekonomike

14. Kërkuesja pretendon se ligji cenon veprimtarinë ekonomike, pasi me detyrimet që imponon, duke caktuar masa shtesë sigurie që përfshijnë përdorimin e sistemit të kamerave me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe etj., ndërhyjnë thellë në veprimtarinë ekonomike të subjekteve. Sipas saj, ndërhyrja e ligjvënësit në veprimtarinë ekonomike nuk është proporcionale, pasi nuk ka një vlerësim real të rrezikut që i kanoset sigurisë, që të ketë çuar në marrjen e këtyre masave ekstreme. Kostot shtesë që u lindin anëtarëve të shoqatës janë të pajustificuara dhe ekstreme.

15. Gjykata vëren se në kërkesën e saj kërkuesja është ndalur konkretisht vetëm tek disa prej neneve të ligjit, megjithëse kërkon shfuqizimin e të gjithë ligjit. Kështu, ajo ka paraqitur argumente për nenin 4, pikat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, nenin 7 dhe nenin 8 të ligjit. Në këto kushte, Gjykata do të ndalet te pretendimet lidhur me këto dispozita të ligjit.

16. Sipas nenit 11/1 të Kushtetutës, sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Gjykata ka vlerësuar se liria e veprimtarisë ekonomike, nënkupton, kryesisht, të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe të shërbimeve, por forma më e lartë e saj nënkupton të drejtën e pronës, lirinë pa asnjë kufizim të qarkullimit të fuqisë punëtore, të kapitalit dhe të mallrave. Po ashtu, liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete edhe lirinë e biznesit ose aftësinë për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, lirinë e tregtisë ose mungesën e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, lirinë monetare si masë për të

garantuar qëndrueshmëri të çmimit, lirinë fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende, të lirë nga ndërhyrja e shtetit, lirinë e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj, lirinë financiare dhe pavarësinë nga kontrolli shtetëror, lirinë e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Liria e veprimtarisë ekonomike përmban edhe detyrimin e shtetit që nëpërmjet ligjvënësit të ndërhyjë në rregullimin e saj, me qëllim që të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i të mirës së përbashkët. Ky detyrim për rregullim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara. Në këtë rast, shteti duhet të luajë rolin e katalizatorit për realizimin efektiv të lirisë ekonomike, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së kësaj lirie, nga ana tjetër. Vetëm shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet që natyrshëm mund t'i mbartë me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata vëren se në rastin konkret ballafaqohen interesat e tregtarëve për të ushtruar lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe, e parë si pjesë e kësaj lirie, për të gëzuar qetësisht pronën e tyre, nga njëra anë, me interesat e shtetit për miratimin e një sërë normash rregulluese për marrjen e masave konkrete, si vendosje të sistemit të videove, me qëllim ruajtjen e sigurisë publike. Për të vlerësuar nëse në këtë rast kushti i baraspeshës është respektuar apo është përmbysur, pra nëse anëtarët e shoqatës për mbrojtjen e tregtarëve dhe të tregut janë ngarkuar me një barrë apo peshë individuale tej masës ose shkallës së duhur, sado i rëndësishëm të jetë interesi publik ose i komunitetit në përgjithësi, në jurisprudencën e saj gjykata ka çmuar të nevojshme të vlerësojë nëse strategjia e ndërhyrjes së ligjvënësit respekton kriteret e mëposhtme: (i) nëse objektivi i ligjvënësit është



mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; (ii) nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin - ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; (iii) nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme.

19. Gjykata ka theksuar se proporcionaliteti i një kufizimi vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh se aspektet e mësipërme nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën (*sib vendimin nr. 33, datë 26.1.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*sib vendimet nr. 52, datë 5.12.2012; nr. 1, datë 6.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket listës së çështjeve me interes publik, Gjykata ka theksuar se ajo nuk mund të jetë kurrësi shteruese, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen (*sib vendimin nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë. Në respektim të interesit publik pranohen si kufizime të arsyeshme të lirisë së veprimtarisë ekonomike iniciativat e ligjvënësit, të cilat shërbejnë për një rregullim të tregut apo interesave të një shteti social. Parimi i shtetit social, i parashikuar që në preambulën e Kushtetutës sonë, e përligj ndërhyrjen e autoritetit publik në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë edhe në marrëdhëniet juridike private për të mbrojtur interesat e përgjithshëm, siç janë kontrolli publik i kostos së jetesës, lufta kundër inflacionit, shtytja dhe nxitja e aktiviteteve prodhuese, mbrojtja e shtresave të varfra, promovimi i vlerave sociale etj. (*sib vendimin nr. 52, datë 5.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Masat e ligjvënësit mund të jenë të shumëllojshme, madje edhe të karakterit monetar, por ajo që ka rëndësi në këtë rast është që thelbi i këtij aktiviteti të individit të mos cenohet deri në atë masë sa të

bëhet i pamundur ushtrimi i tij (*sib vendimin nr. 10, datë 19.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Megjithatë, për shkak të natyrës teknike që paraqet kuadri ligjor i tatimeve dhe taksave, diskrecioni i ligjvënësit duhet të respektojë në të gjitha rastet domosdoshmërisht parimet e drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës të sanksionuara në Kushtetutë. Këto parime janë universale. Ato duhet të ndiqen si në bërjen e ligjeve, ashtu dhe në zbatimin e tyre. Ato nënkuptojnë se të gjitha institucionet shtetërore duhet të veprojnë vetëm në bazë dhe në zbatim të ligjit dhe se të drejtat dhe liritë e njeriut duhet të respektohen. Gjithashtu, ato presupozojnë faktin se masat e vendosura nga shteti duhet të jenë proporcionale, në përputhje me objektivat legjitimë e të rëndësishëm dhe nuk duhet të vendosin kufizime në një masë më të madhe se sa është e nevojshme për të arritur këta objektiva.

22. Gjykata rithekson se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve ajo nisët nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se lidhur me antikushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrihen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*sib vendimet nr. 16, datë 1.3.2017, dhe nr. 4, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Duke iu kthyer çështjes konkrete për gjykim, Gjykata vëren se referuar nenit 4 të ligjit objekt shqyrtimi rezulton se ky nen parashikon subjektet që duhet të marrin masa shtesë sigurie pas vlerësimit të analizës së rrezikut të bërë nga Policia e Shtetit. Konkretisht, subjektet që detyrohen nga ligji janë këto:

a) subjektet që kanë selinë e mjediset e punës dhe ushtrojnë aktivitetin tregtar në vende të ekspozuara ndaj rrezikut të shtuar për sigurinë;

b) subjektet që kanë mbi 50 punonjës dhe/ose frekuentues, të cilët në mënyrë të vazhdueshme akomodohen apo frekuentojnë në të njëjtën kohë një mjedis të hapur ose të mbyllur;

c) subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar nga ora 23:00 – 06:00;

ç) subjektet që kanë aktivitet ekonomik, xhiroja vjetore e të cilave është mbi 10 milionë lekë.

24. Më tej, neni 7 parashikon faktorët për vlerësimin e rrezikut, ndërsa neni 8 masat shtesë të sigurisë. Konkretisht:



Neni 7 - Faktorët për vlerësimin e rrezikut

Policia e Shtetit bën analizën e vlerësimit të rrezikut, duke u bazuar në faktorët e mëposhtëm: a) veprimtarinë e subjektit, e cila ka qenë objekt i sulmeve të vazhdueshme kriminale, që kanë cenuar sigurinë e subjektit në 5 vjetët e fundit; b) ekspozimin e mjedisve e të aktivitetit të subjektit ndaj elementëve kriminalë; c) frekuentimin e lokaleve e të mjedisve nga personat me precedentë kriminalë dhe penalë; ç) llojin e veprimtarisë që kryhet; d) distancën e objektit ku ushtrohet veprimtaria nga njësia policore apo qendrat e banuara.

Neni 8 - Masat shtesë të sigurisë

1. Masat shtesë të sigurisë janë: a) përdorimi i sistemit të kamerave CCTV, me rezolucion të lartë dhe me rreze infra të kuqe, që ruajnë imazhet filmike në NRV/Server deri në 2 muaj; b) përdorimi i pajisjeve elektronike të teknologjisë së lartë për identifikimin, në funksion të sigurisë (detektorë, ura kontrolli, reader, GPS etj.); c) të kryejnë, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, në nivel qendror dhe vendor, lidhjen e sinjalit të alarmit me bankat dhe objektet e rëndësishë së veçantë, me sallat e komandimit/informacionit të Policisë së Shtetit; ç) përdorimi i Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike (SHPSF).

2. Niveli i masave shtesë të sigurisë dhe lloji i masës që duhet të përdorin subjektet, sipas pikës 1 të këtij neni, në varësi të aktivitetit apo vlerësimit të rrezikut, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

3. Standardet teknike të sistemit të kamerave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Vendosja dhe përdorimi i masave shtesë të sigurisë duhet të shoqërohet, sipas rastit, me njoftimin për publikun, si dhe duhet të respektojë dinjitetin e individit.

25. Gjykata vëren se ndonëse kërkuesja ka pretenduar se ndërhyrja e ligjvënësit me miratimin e ligjit të kundërshtuar nuk respekton parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, ajo nuk ka arritur të provojë se si dhe në ç'masë i kufizohet liria e veprimtarisë ekonomike në rastin konkret. Kërkuesja nuk arriti të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis rëndimit ekonomik të pretenduar prej saj dhe shtimit të masave të sigurisë publike. Gjithashtu, ajo nuk arriti të provojë se për shkak të vlerësimit të situatave të rrezikut të shtuar dhe mënyrës se si vlerësohet dhe garantohet siguria publike nga autoritetet përgjegjëse, sipas neneve 4, 7 dhe 8 të ligjit, asaj ose anëtarëve të saj i vijnë pasoja të rënda

ekonomike. Gjykata vëren se ligji nr. 19/2016 objekt shqyrtimi ka si qëllim dhe fushë të rregullimit të tij rritjen e sigurisë publike dhe jo rregullimin e aktivitetit ekonomik dhe tregtar të subjekteve private. Prandaj i takon kërkueses të argumentojë se cili është dëmi real dhe i drejtpërdrejtë që sjell ky ligj në veprimtarinë tregtare të anëtarëve të saj, pra se në ç'mënyrë dhe në ç'masë preken ata nga këto rregullime ligjore.

26. Në këto kushte, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesja nuk ka paraqitur fakte dhe argumente të nivelit kushtetues se përse rregullimet e ligjvënësit në këtë rast nuk respektojnë parimin e proporcionalitetit, sipas nenit 17 të Kushtetutës dhe si rrjedhim kërkesa duhet të rrëzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/a dhe 134/1/h të Kushtetutës, si dhe të neneve 49, 51, 51/a, 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 61, datë 31.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“



me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.7.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 34 Akti, që i përket:

KËRKUES: Aleksandër Shpati

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2016-2329, datë 22.12.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Gani Dizdari, parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 409, datë 25.7.2014, midis të tjerave, ka vendosur: “*Deklarimin fajtor të të pandeburit Aleksandër Shpati për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal (KP) dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim. Deklarimin fajtor për veprën penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, parashikuar nga neni 278/4 i KP-së dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim. Në bashkëim të dënimeve i pandeburi Aleksandër Shpati dënohet me 15 vjet burgim*”.

2. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 165, datë 16.4.2015, ka vendosur: “*Lëniën në fuqi të vendimit*”.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-2329, datë 22.12.2016, në dhomë këshillimi, ka vendosur: “*Mospranimin e rekursit*”.

II

4. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal me arsyetimin se baza ligjore mbi të cilën është dënuar kërkuari për mbajtje dhe prodhim të armëve luftarake është shfuqizuar me vendimin nr. 9, datë 26.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese, pra para se Kolegji Penal të merrte në shqyrtim rekursin e tij. Si rrjedhojë, vendimi i Kolegjit Penal bie ndesh me nenin 29/3 të Kushtetutës, pasi bazohet mbi një ligj që nuk ishte në fuqi në momentin e marrjes së tij, duke cenuar parimin e dënimit me ligj dhe parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues.

5. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka parashtruar para Gjykatës se pretendimet e ngritura nga kërkuari lidhur me aplikimin e dispozitës materiale për dënimin e tij, nën optikën e parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit favorizues, janë të bazuara. Kolegji Penal duhej të kishte marrë parasysh ndryshimet favorizuese të bëra nga ligjvënësi në KP, si pasojë e vendimit nr. 9/2016 të Gjykatës Kushtetuese.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

6. Kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, në kuptim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura në kërkesë janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Gjykata ka theksuar se në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga individ përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të



paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 31/2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

B. Për pretendimin e cenimit të sigurisë juridike për shkak të moszbatimit të ligjit penal favorizues

7. Sipas kërkesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin kushtetues të zbatimit të ligjit penal favorizues, duke zbatuar një ligj që nuk ishte në fuqi në kohën e gjykimit të tij para atij Kolegji. Konkretisht, kërkuesi është deklaruar fajtor dhe është dënuar bazuar në pikën 4 të nenit 278 të KP-së, e cila u shfuqizua si antikushtetuese me vendimin nr. 9/2016 të Gjykatës Kushtetuese, sepse nuk respektonte parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes nga ligjvënësi, duke qenë se masa e dënimit ishte tejet e rëndë dhe e pajustificuar. Në këto kushte, Kolegji Penal, sipas kërkesit, duhej të kishte vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatat më të ulëta për ndryshimin e masës së dënimit sipas ligjit të ri dhe jo të vendoste mospranimin e rekursit.

8. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 35/2005; nr. 14/2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 52/2013; nr. 3/2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4/2006; nr. 19/2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, ndërkohë që çështja ndodhej për shqyrtim në Kolegjin Penal, kjo Gjykatë, me vendimin nr. 9/2016, ka shfuqizuar paragrafin e pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të KP-së, mbi bazë të të cilit është dënuar kërkuesi. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, me ligjin nr. 82/2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, neni 278 i KP-së është riformuluar, duke ndryshuar masat e dënimit, konkretisht duke i ulur ato. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 151, datë 11.8.2016. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-2329, datë 22.12.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkesit, duke mos marrë parasysh ndryshimet ligjore të ndodhura ndërkohë që çështja ishte për gjykim para tij.

11. Gjykata thekson se neni 29/3 i Kushtetutës parashikon se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Kjo dispozitë kushtetuese reflektohet edhe në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale. Parimi i përgjithshëm që vepron në sistemin e së drejtës është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit. Përrjashtimi që bëhet nga rregulli i përgjithshëm, duke i dhënë fuqi prapavepruese vetëm ligjit penal që favorizon pozitën e të pandehurit, synon t'i përgjigjet në mënyrë sa më të shpejtë e të përshtatshme vlerësimeve të ligjvënësit mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprimeve apo mosveprimeve të caktuara, si dhe të subjekteve që i kanë kryer apo mund t'i kryejnë ato në të ardhmen. Gjykata ka theksuar se parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Ky parim duhet të respektohet edhe nga Gjykata e Lartë, sepse është pikërisht kjo Gjykatë që kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 49/2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar se është kompetencë e Kolegjit të Gjykatës së Lartë të analizojë dhe vlerësojë në dhomën e këshillimit nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Neni



432 i KPP-së ka parashikuar shkaqet për të cilat mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë, kurse neni 433 i po këtij Kodi parashikon se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i rekursit vendoset nga Kolegji në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimin nr. 8/2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh se dispozita ligjore penale që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale ka ndryshuar gjatë kohës së gjyqimit të çështjes nga ai kolegji. Pavarësisht se kërkuesi nuk e ka paraqitur këtë pretendim para Gjykatës së Lartë, pasi rekursi është bërë në datën 6.5.2015, pra para ndryshimit të ligjit, i takonte Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që të zbatonte ligjin penal të ri, nisur edhe nga fakti se masa e dënimit që parashikonte ishte në favor të të gjykuarit për sa i takon veprës penale të mbajtjes së armëve luftarake pa leje. Në këtë rast, Kolegji Penal duhej të kishte marrë parasysh ndryshimin favorizues të masës së dënimit për këtë vepër penale në zbatim të një parimi të rëndësishëm kushtetues, siç është siguria juridike. Në këto kushte, ai Kolegji, me vendimin e tij, ka cenuar procesin e rregullt ligjor ndaj kërkuetit.

14. Gjykata edhe në raste të mëparshme të ngjashme ka mbajtur qëndrimin se, megjithëse është e njohur se fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues përbën një nga parimet themelore të procesit gjyqësor të garantuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka mënjanuar respektimin e këtij standardi kushtetues, duke sjellë si pasojë një proces të parregullt ligjor (*shih vendimin nr. 49/2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Duke marrë parasysh rrethanat më lart, Gjykata konstaton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet ta kishte marrë në konsideratë efektin prapaveprues të ligjit penal favorizues, si një nga elementët themelore të procesit penal të garantuar shprehimisht në nenin 29/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këto kushte, Kolegji

Penal i Gjykatës së Lartë duke mënjanuar respektimin e këtij standardi kushtetues ka cenuar njëkohësisht edhe parimin e sigurisë juridike.

16. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar një proces të parregullt ligjor ndaj kërkuetit dhe për këtë arsye kërkesa duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Shfuqizimin si të papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2016-2329, datë 22.12.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vetëm për sa i përket kërkuetit Aleksandër Shati.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 62, datë 31.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 27.6.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 30 Akti, që u përket:



KËRKUES: Sulejman Habibi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Bashkia e Tiranës, Avokatura e Shtetit, Përmbaruesi Gjyqësor Privat

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 526, datë 18.10.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15/2, 17, 18, 33/1, 43, 44, 131/f, 134/1/i dhe 135/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Bashkisë së Tiranës, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 4909, datë 7.10.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi Sulejman Habibi. Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë që të shpronësojë për interes publik pasurinë nr. 4/681, Z. K. 8150, vol. 42, faqe 250, të llojit “truall”, me sipërfaqe 50 m², e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në emër të paditësit Sulejman Habibi. Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë, që të dëmshpërblejë paditësin Sulejman Habibi në vlerën 2.856.300 lekë. Ky vendim është titull ekzekutiv në kuptim të nenit 510/a të KPC-së dhe është drejtpërdrejt i ekzekutueshëm nga Zyra e Përmbarimit nga momenti që ai marrë formë të prerë”*. Sipas këtij vendimi rezulton se ai ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar.

2. Ankuesi, Bashkia e Tiranës, ka paraqitur ankim kundër vendimit të mësipërm në datën 23.10.2015. Me vendimin nr. 110 akti, datë 10.11.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur mospranimin e ankimit, si i paraqitur jashtë afatit, duke arsyetuar se në seancën gjyqësore për shpalljen e vendimit ka qenë i pranishëm përfaqësuesi i këtij subjekti.

Faqe | 7346

3. Në datën 20.1.2016, përmbaruesi gjyqësor ka nisur procedurat për ekzekutimin e vendimit, duke i dërguar palës debitore lajmërim për ekzekutimin vullnetar dhe më tej ka vijuar edhe me procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm. Me shkresën e datës 1.3.2016, përmbaruesi gjyqësor ka urdhëruar vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e palës debitore, kurse me shkresën e datës 20.7.2016 ka urdhëruar bllokimin e llogarisë së palës debitore pranë Degës së Thesarit Tiranë në zërin shpenzime në zërin art. 602.

4. Me vendimin nr. 34, datë 16.3.2016, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur ndaj vendimit nr. 110 akti, datë 10.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, me arsyetimin se ky ankim është paraqitur jashtë afatit ligjor 5-ditor.

5. Me kërkesën e datës 3.10.2016, Bashkia e Tiranës i është drejtuar Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 34, datë 16.3.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit. Sipas dosjes gjyqësore të kërkesës për pezullim, e kërkuar për qëllime të këtij shqyrtimi, nuk rezulton i administruar rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë, por vetëm një informacion i nxjerrë nga sistemi i menaxhimit të çështjeve të kësaj gjykate, sipas të cilit është regjistruar një rekurs me palë Bashkinë e Tiranës dhe Sulejman Habibin dhe objekt rivendosjen në afat.

6. Me vendimin nr. 526, datë 18.10.2016, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit ka vendosur: *“Pezullimin e ekzekutimit për zbatimin e vendimit nr. 34, datë 16.3.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 4909, datë 7.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”*, me arsyetimin se kërkesa përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 479 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

7. **Kërkuari Sulejman Habibi** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

7.1. *Është cenuar parimi i sigurisë juridike*. Gjykata e Lartë ka anashkaluar dhe nuk ka pasur parasysh urdhërimet dhe dispozitivin e vendimit gjyqësor të



formës së prerë nr. 4909, datë 7.10.2015, duke anashkalluar edhe të gjitha pasojat ligjore që ka sjellë ky vendim.

7.2. Është cenuar standardi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Vendimi nr. 4909, datë 7.10.2015 ka marrë formë të prerë dhe nuk është ankimuar në Gjykatën e Apelit, për rrjedhojë ndaj tij nuk ka rekurs. Ndryshe nga sa ka vendosur Gjykata e Lartë në dispozitivin e vendimit të pezullimit, vendimi nr. 34, datë 16.3.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka lidhje me themelin e gjykimit dhe nuk është shprehur në lidhje me vendimin nr. 4909, datë 7.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kontrolli i Gjykatës së Lartë duhej të kufizohej vetëm në drejtëm të ligjshmërisë së vendimeve të ankimuara, ndërkohë që ajo gjykatë ka arritur në një konkluzion të ndryshëm nga Gjykata e Apelit, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj. Procesi në marrjen e vendimit të pezullimit vjen në kundërshtim me nenin 479 të KPC-së dhe është i parregullt në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

7.3. Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk plotëson këto kërkesa. Ai është jokohërent dhe ka përplasje mes fakteve në lidhje me vendimet në të cilat është bazuar.

8. **Subjekti i interesuar, Bashkia e Tiranës**, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka parashtruar sa vijon:

8.1. Pretendimet e kërkuarit kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit, të cilat nuk përbëjnë juridiksion kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kërkuari ka argumentuar gabim pretendimet në kërkesë, për rrjedhojë nuk legjitimohet *ratione materiae*.

8.2. Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar. Referuar vendimit të Kolegjit Administrativ ai përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë dhe disponimet e gjykatave më të ulëta. Ai është mbështetur vetëm mbi faktet që janë paraqitur dhe përmban edhe bazën ligjore. Ky vendim nuk mund të shkojë më tej, për shkak se nuk është një vendim përfundimtar, që nënkupton se i është përgjigjur vetëm kërkesës së paraqitur nga Bashkia e Tiranës.

8.3. Në lidhje me pretendimin për cenimin e standardit të gjykatës së caktuar me ligj, Kolegji Administrativ e ka zbatuar me rigozitet atë, pasi

vendimi i marrë prej tij është bazuar në një procedurë të parashikuar saktësisht në ligj, për rrjedhojë pretendimi është i pabazuar.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Gjykata vëren se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit.

10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, neni 131/1/f i Kushtetutës parashikon se individit mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të pretendimeve të tij për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi nënkupton se kërkuari duhet t’i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 1, datë 25.1.2010; nr. 17, datë 16.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata ka vlerësuar se Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe të frytshëm të mundshëm. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Dhunimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeleve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e dhunimit të kësaj të drejte (*shih vendimin nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).



12. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar prej saj, vëren se edhe pse Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për të shqyrtuar një rekurs që ka të bëjë me rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit dhe jo me themelin e mosmarrëveshjes, në dispozitivin e vendimit të pezullimit ajo shprehet për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 4909, datë 7.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili ka zgjidhur në themel mosmarrëveshjen mes palëve dhe ka marrë formë të prerë. Edhe pse objekt i kërkesës në shqyrtim është një vendim pezullimi i Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson se kjo çështje paraqet veçanti, për arsye se, në kuptim të nenit 131/1/f të Kushtetutës, ky vendim ka sjellë pasoja, duke penguar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në vlerësimin e Gjykatës askush nuk mund të pengojë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, përfshirë edhe gjykatat, në qoftë se ato nuk janë të autorizuar nga ligji. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione materia* për të vënë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe atij të sigurisë juridike

13. Sipas kërkuetit, Gjykata e Lartë ka anashkaluar e nuk ka pasur parasysh urdhërimet dhe dispozitivin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 4909, datë 7.10.2015. Duke vendosur pezullimin e këtij vendimi pa pasur një rekurs kundër tij, Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe të gjykatës së caktuar me ligj. Sipas kërkuetit është cenuar, gjithashtu, edhe standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është jokohorent dhe ka përplasje mes fakteve në lidhje me vendimet në të cilat është bazuar.

14. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ky element karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të

caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 2, datë 22.1.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata, bazuar në aktet e dosjeve gjyqësore (të themelit dhe të kërkesës për pezullim), konstaton se kundër vendimit nr. 4909, datë 7.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me të cilin është vendosur pranimi i kërkesëpadsisë së paraqitur nga kërkuesi, është paraqitur ankim nga subjekti i interesuar Bashkia e Tiranës, i cili, me vendimin nr. 110 akti, datë 10.11.2015 të po asaj gjykate, është konsideruar si i paraqitur jashtë afatit ligjor. Kundër këtij vendimi (për mospranimin e ankimit) subjekti i interesuar ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila, me vendimin nr. 34, datë 16.3.2016, ka vendosur sërish mospranimin e tij si të paraqitur jashtë afatit ligjor 5-ditor të parashikuar për ankimin e vendimeve të veçanta. Kundër këtij vendimi të Gjykatës së Apelit, Bashkia e Tiranës ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, ku ka ngritur pretendime në lidhje me llogaritjen e afateve ligjore për llogaritjen e ankimit, duke kërkuar edhe ndryshimin e vendimeve të mësipërme nr. 110, datë 10.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nr. 34, datë 16.3.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit. Bashkë me rekursin, subjekti i interesuar ka paraqitur në Gjykatën e Lartë edhe kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 34, datë 16.3.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Pasi ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë, Gjykata e Lartë ka vendosur pranimin e saj.

16. Nga përmbajtja e vendimit të pezullimit rezulton se për sa i takon vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme në lidhje me çështjen, Gjykata e Lartë i referohet vendimit nr. 4909, datë 7.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe atij nr. 34, datë 16.3.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të cilin në pjesën arsyetuese e referon si vendimi që ka lënë në fuqi vendimin nr. 4909, datë 7.10.2015, ndërkohë që këto dy vendime u përkasin vendimmarrjeve të ndryshme të gjykatave të faktit. Ndërsa vendimi nr. 4909, datë 7.10.2015, ka të bëjë me themelin e mosmarrëveshjes mes palëve, vendimi nr. 34, datë 16.3.2016, i referohet ankimit kundër



vendimit nr. 110, datë 10.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që nuk ka pranuar ankimin kundër vendimit nr. 4909 si i paraqitur jashtë afatit ligjor. Më tej, në dispozitivin e vendimit, Gjykata e Lartë shprehet: “*Pezullimin e ekzekutimit për zbatimin e vendimit nr. 34, datë 16.3.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 4909, datë 7.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*”. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se edhe pse Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për shqyrtimin e një rekursi që kundërshton një vendim gjyqësor, i cili është shprehur në lidhje me respektimin e afateve ligjore të ankimit, ajo ka vendosur pezullimin edhe të vendimit gjyqësor që ka shqyrtuar themelin e mosmarrëveshjes mes palëve, i cili i përket një procesi gjyqësor të ndryshëm nga ai që është në shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Duke vepruar në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore në kundërshtim me parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

17. Gjykata vlerëson se duke u shprehur për pezullimin e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili nuk është objekt ankimi dhe shqyrtimi para saj, Gjykata e Lartë ka cenuar, në këtë mënyrë, edhe parimin e sigurisë juridike, i cili, mes të tjerash, garanton qëndrueshmërinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si edhe besueshmërinë e individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike lidhet me faktin se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera (*shih vendimin nr. 2, datë 29.1.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pezullimi nga Gjykata e Lartë i një vendimi themeli që ka marrë formë të prerë, pa pasur një rekurs nga palët kundër tij, është një vendim arbitrar, që vjen në kundërshtim me ligjin dhe njëkohësisht cenon parimin kushtetues të gjykatës së caktuar me ligj dhe atë të sigurisë juridike.

19. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të asytitimit të vendimit të Gjykatës së

Lartë, Gjykata vlerëson të mos e marrë në shqyrtim atë për sa kohë që më sipër ka konstatuar se procesi i zhvilluar në atë gjykatë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 71/a, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, më shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 526, datë 18.10.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuar Sulejman Habibi nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, pasi në vlerësimin tim Gjykata duhet të kishte vendosur moslegjitimitimin e kërkuar, në kuptim të nenit 131/1/f të Kushtetutës.

2. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, individ mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Në kuptim të nenit 131/1/f të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar, që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore. Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi



i padive dhe i apelimeve (*shih vendimin nr. 10, datë 09.5.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Shterimi i mjeteve të ankimit në gjykatat e zakonshme është një kusht, i cili bën të mundur juridiksionin kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt. Në këtë mënyrë, ky rregull përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit se procedura e zgjidhjes së ankesave individuale përpara Gjykatës Kushtetuese është plotësuese e gjykimit në gjykatat e zakonshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese (parimi i subsidiaritetit) (*shih vendimin nr. 23, datë 4.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese*). Çështja e shterimit të mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet përmbushur nga kërkuesi, që do të thotë se individi përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 17, datë 16.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm pasi individët të kenë konsumuar edhe shkallën e fundit të kontrollit gjyqësor të zakonshëm, këto vendime mund të kontrollohen nga Gjykata Kushtetuese nga pikëpamja e kushtetutshmërisë së tyre. Mbi këtë bazë bëhen objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese ato çështje gjyqësore të paraqitura nga individët për shkeljen e të drejtave të tyre, pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk ekzistojnë më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

4. Në kuptim të sa më sipër vlerësoj se në rastin konkret nuk ndodhemi përpara një vendimi përfundimtar as nga pikëpamja formale, as nga ajo substanciale, çka do të legjitimonte kundërshtimin e tij para Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata e Lartë pezullon ekzekutimin e vendimit kur: a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit. Vendimi për pezullimin e ekzekutimit ka karakter të përkohshëm dhe efektet e tij zgjasin deri në dhënien e një vendimi përfundimtar nga gjykata

në lidhje me rekursin e paraqitur ose deri në dhënien e një vendimi tjetër që mund të ndryshojë masën e dhënë. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë nuk shprehet për themelin e mosmarrëveshjes mes palëve dhe në ndryshim nga sa arsyeton shumica, as për nga efektet e tij nuk mund të barazohet me një vendim përfundimtar.

5. Edhe pse Gjykata e Lartë në rastin konkret ka marrë në shqyrtim dhe ka pranuar kërkesën për pezullim, pavarësisht se ishte vënë në lëvizje në bazë të një rekursi për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, ky vendim nuk ka sjellë asnjë pasojë në lidhje me vendimin e themelit të çështjes që ka pranuar kërkesëpadinë e kërkuesit. Po ashtu, vlerësoj se kërkuesi nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore që t'i drejtohej Gjykatës së Lartë, në mënyrë që ajo vetë të merrte masat për të korrigjuar vendimin e saj në rast se do të vlerësonte se ishte para një rasti të tillë.

6. Për të gjitha argumentet e mësipërme, vlerësoj se kërkuesi Sulejman Habibi nuk legjitimohet *ratione materiae* për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 131/1/f të Kushtetutës.

Anëtare
Vitore Tusha

VENDIM

Nr. 63, datë 31.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.7.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 35 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Sonila Shkjezi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Financave, Zyra Përmbarimore “Bailiff’s Services-Matani Co”



OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42/1, 44, 49/1, 131/1/f, 134/1/i dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 31 dhe 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, që kërkoji pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, zyrës përbarimore “Bailiff’s Service-Matani Co”, që kërkoji pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Ministria e Financave, që kërkoji rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në datën 13 tetor 2008, kërkuësja është punësuar në pozicionin e drejtorit të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integritimit European në Ministrinë e Financave.

2. Me shkresën nr. 16977/2, datë 9.12.2013, të sekretarit të përgjithshëm, kërkuësja njoftohet se ka kaluar në listë pritjeje në pozicionin drejtor në Drejtorinë e Integritimit European të Ministrisë së Integritimit European. Kërkuësja e ka kundërshtuar urdhrin në rrugë administrative, po nuk ka marrë asnjë përgjigje.

3. Në këto kushte, kërkuësja i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt shfuqizimin e urdhrin të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Financave, si të nxjerrë në kundërshtim me ligjin.

4. Gjykata Administrative Tiranë, me vendimin nr. 953, datë 11.3.2014, ka vendosur: *“Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Financave, që të transferojë paditësen në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditëses pagën e këtij pozicioni prej datës 8.12.2013 e në vazhdim”*.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 224, datë 11.2.2015, ka vendosur: *“Lënien në fuqi*

të vendimit nr. 953, datë 11.3.2014, të Gjykatës Administrative Tiranë”.

6. Në datën 3.4.2015, kërkuësja i është drejtuar me një kërkesë shoqërisë përbarimore “Bailiff’s Services-Matani Co” sh.p.k. duke i kërkuar nisjen e procedurës për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv “Vendim gjyqësor”, nr. 953, datë 11.3.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

7. Shoqëria përbarimore, me shkresën nr. 750 Prot. datë 3.4.2015, i është drejtuar Ministrisë së Financave me kërkesë për ekzekutimin vullnetar të titullit ekzekutiv “Vendim gjyqësor”, nr. 953, datë 11.3.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

8. Më tej, shoqëria përbarimore, me shkresën nr. 1180 Prot. datë 20.5.2015, i është drejtuar Ministrisë së Financave me kërkesë për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv “Vendim gjyqësor”, nr. 953, datë 11.3.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

9. Mbi rekursin e ushtruar nga Ministria e Financave, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 2350, datë 19.5.2016, vendosi: *“Mospranimin e rekursit”*.

10. Me shkresën nr. 2230 Prot. datë 22.9.2016, shoqëria përbarimore i është drejtuar përsëri me kërkesë Ministrisë së Financave për ekzekutim të titullit ekzekutiv “Vendim gjyqësor”, nr. 953, datë 11.3.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

11. Me shkresën nr. 2604 Prot. datë 27.10.2016, shoqëria përbarimore i është drejtuar Degës së Thesarit me urdher për vendosjen e masës së sekuestros konservative. Kjo e fundit i ka kthyer të gjithë praktikën pa veprim, me shkresën nr. 6857/1, datë 21.11.2016.

12. Me shkresën nr. 456 Prot. datë 8.3.2017, shoqëria përbarimore i është drejtuar sërish Ministrisë së Financave me njoftim për shlyerjen e detyrimit, duke e paralajmëruar për ndërmarrjen e sanksioneve ligjore sipas nenit 606/3 të KPC-së dhe 320 të KP-së. Pala debitore, Ministria e Financave, nuk ka kthyer asnjë përgjigje në vijim të këtyre shkresave dhe njoftimeve.

13. Në datën 8.3.2017, kërkuësja i është drejtuar me një kërkesë për ekzekutim vendimi gjyqësor edhe ministrit të Financave, por as në këtë rast ajo nuk ka marrë ndonjë përgjigje.



II

14. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

15. **Subjekti i interesuar, zyra përmbarimore “Bailiff’s Services-Matani Co”**, pretendon se i ka kryer të gjitha veprimet procedurale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, por pala debitorë, Ministria e Financave, nuk ka marrë asnjë masë për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

16. **Subjekti i interesuar, Ministria e Financave**, prapësoi pretendimet e kërkueses, duke parashtruar se:

16.1 Kërkesa është paraqitur jashtë afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a i ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Për këtë arsye, kërkesa nuk duhet pranuar.

16.2 Gjithashtu, duke qenë se vendimi i fundit gjyqësor është ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili është marrë në shtator të vitit 2016, bazuar në ligjin për buxhetin e shtetit, institucioni ynë duhet të planifikojë shpenzimet e nevojshme për shlyerjen e detyrimeve që vijnë nga vendimet gjyqësore për vitin pasardhës. Në këto kushte, ne nuk jemi në kushtet e mosveprimit, por jemi duke parashikuar fondin e nevojshëm për vitin pasardhës për shlyerjen e detyrimit financiar.

16.3 Lidhur me kthimin në punë, është e nevojshme që të theksohet se njësia përgjegjëse për emërimin e nëpunësve civilë që janë në listë pritje është Departamenti i Administratës Publike dhe jo Ministria e Financave. Për këtë arsye, nuk mund të bëhet zbatimi i detyrimit të kthimit në punë i kërkueses nga ana jonë, pasi nuk e parashikon ligji.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

17. Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, dhe nenit 31 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

18. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e së drejtës kushtetuese të individit për një proces të rregullt, dhe Gjykata ndërhyr atëherë kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë këtë të drejtë. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 03/2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkuesit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individit, në kuptim të neneve 131/f, 134/1/i dhe 134/2 të Kushtetutës, mund ta vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 52/2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Kërkuesja ka interes të ligjshëm për të kërkuar zbatimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm dhe në rastin konkret ajo u është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës së saj. Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, kërkuesja i është drejtuar debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, si edhe shërbimit përmbarimor për fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm. Madje, ajo i është drejtuar edhe ministrit të Financave për t’i kërkuar ndërhyrjen për ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe nuk ka marrë asnjë përgjigje.

21. Për sa më sipër, kërkuesja legjitimohet *ratione materiae* për t’iu drejtuar kësaj Gjykate për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të



vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi ajo ka përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion dhe nuk ka mjet tjetër për rivendosjen e së drejtës të cenuar.

B. Për pretendimin e mosekzekutimit të vendimeve të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm

22. Kërkuësja pretendon se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga ana e palës debitore, Ministrisë së Financave, e cila, sipas kërkuëses, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të shlyer detyrimin ndaj saj.

23. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 50/2017; nr. 79/2016; nr. 21/2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjydhshëmrisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë edhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ai që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë.

25. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të

justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 79/2016; nr. 14/2015; nr. 21/2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimin nr. 79/2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuësit, si dhe të autoriteteve përkatëse.

28. Duke e vlerësuar çështjen konkrete në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme, në rastin konkret rezultoi se nga data kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë, 11.3.2014, deri në paraqitjen e kërkesës para kësaj Gjykate ka kaluar një periudhë 3-vjeçare. Nga dokumentet të cilat shoqërojnë kërkesën rezultoi se debitori nuk ka kryer asnjë veprim për ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Një periudhë e tillë lidhur me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, në vlerësimin e Gjykatës, konsiderohet si një afat i paarsyeshëm dhe i gjatë, duke marrë parasysh edhe mosveprimin e palës debitore lidhur me shlyerjen e detyrimit ligjor.

i. Kompleksiteti i çështjes

29. Për vlerësimin e kompleksitetit të çështjes duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 79/2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në rastin konkret çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm për kthimin e kërkuëses në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e detyrimeve monetare



përkatëse sipas vendimit gjyqësor. Kjo çështje nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuases është me rëndësi në këtë kontekst.

ii. Interesi dhe sjellja e kërkuases

31. Në rastin konkret interesi i kërkuases është i dukshëm dhe real, për sa kohë që detyrimi i palës debitore lidhet me të drejtën e saj për t'u kthyer në punë dhe për t'u paguar sipas vendimit gjyqësor. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuësja ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për ekzekutimin e detyrimit, që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Ajo ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim. Kështu, referuar materialeve bashkëlidhur kërkesës rezulton se me shkresën nr. 16977/2, datë 9.12.2013, të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Financave, kërkuësja njoftohet se ka kaluar në listë pritjeje në pozicionin drejtor në Drejtorinë e Integritimit Europian. Kërkuësja e ka kundërshtuar në rrugë administrative urdhrin, po nuk ka marrë përgjigje. Ajo më pas i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shfuqizimin e urdhrin të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Financave. Gjykata Administrative Tiranë, me vendimin nr. 953, datë 11.3.2014, ka vendosur: *“Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Financave, që të transferojë paditësen në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditëses pagën e këtij pozicioni prej datës 8.12.2013 e në vazhdim”*. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 224, datë 11.2.2015, ka vendosur: *“Lëni në fuqi të vendimit nr. 953, datë 11.3.2014, të Gjykatës Administrative Tiranë”*. Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar rekursin e ushtruar nga pala debitore.

iii. Sjellja e autoriteteve

33. Gjykata ka theksuar se në fazën e ekzekutimit marrin pjesë jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori

nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij ndaj kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 24/2014; nr. 6/2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor e humbasin qëllimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr. 6/2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në lidhje me autoritetet publike të përfshira në këtë proces duhet të shqyrtohet sjellja e secilit prej tyre. Për sa u përket veprimeve të përmbaruesit gjyqësor privat, si subjekt procedural në fazën e ekzekutimit, rezulton se shoqëria përmbarimore, me shkresën nr. 750 Prot., datë 3.4.2015, i është drejtuar Ministrisë së Financave me kërkesë për ekzekutimin vullnetar të titullit ekzekutiv “Vendim gjyqësor”, nr. 953, datë 11.3.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Shoqëria përmbarimore, me shkresën nr. 1180 Prot., datë 20.5.2015, i është drejtuar Ministrisë së Financave me kërkesën për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv “Vendim gjyqësor”, nr. 953, datë 11.3.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjithashtu, me shkresën nr. 2230 Prot., datë 22.9.2016, shoqëria përmbarimore i është drejtuar përsëri me kërkesë Ministrisë së Financave për ekzekutimin e titullit ekzekutiv “Vendim gjyqësor”, nr. 953, datë 11.3.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kjo kërkesë është përsëritur në datën 27.10.2016, duke i kërkuar edhe Degës së Thesarit të vendosë masën e sekuestros konservative. Kjo e fundit i ka kthyer të gjithë praktikën pa veprim, me shkresën nr. 6857/1, datë 21.11.2016. Më tej, përmbaruesi, me shkresën nr. 456 Prot., datë 8.3.2017, i është drejtuar sërish Ministrisë së Financave me



njoftim për shlyerjen e detyrimit, duke e paralajmëruar për ndërmarrjen e sanksioneve ligjore sipas nenit 606/3 të KPC-së dhe 320 të KP-së. Pala debitore, nuk ka kthyer asnjë përgjigje në vijim të këtyre shkresave dhe njoftimeve.

36. Pavarësisht se shoqëria përmbartimore ka kryer disa nga veprimet e parashikuara nga ligji për ekzekutimin, ajo nuk ka qenë shteruese në ndërmarrjen e hapave të tjerë të nevojshëm të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor, duke filluar nga vendosja e gjobës për zyrtarët përgjegjës deri në kallëzimin penal për moszbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Referuar dosjes gjyqësore dhe parashtrësave të sjella nga kërkuesja dhe shoqëria përmbartimore rezulton se këto veprime nuk janë ndërmarrë prej saj.

37. Për sa i takon veprimeve të kryera nga ana e palës debitore, Gjykata ka theksuar vazhdimisht se i takon asaj të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së palës kreditore. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë objektive për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë. Gjykata ka theksuar gjithashtu se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej i paekzekutuar dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimin nr. 14/2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Gjykata thekson se pala debitore është shmangur nga detyrimi për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë me mosveprim duke heshtur ndaj një detyrimi ligjor. Ajo duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme dhe duhej të gjente mjetin e përshtatshëm ligjor për kthimin e kërkueses në punë, si dhe pagesën e saj si një detyrim ligjor, i cili rrjedh nga një vendim gjyqësor që tashmë është titull ekzekutiv.

39. Gjithashtu, Gjykata e gjen si të papranueshme dhe ligjërish të pabazuar sjelljen e Degës së Thesarit Tiranë. Me shkresën nr. 6857/1 Prot., datë 21.11.2016, Dega e Thesarit i ka bërë me dije kërkueses se kërkesa për ekzekutim të detyrueshëm nuk duhet t'i drejtohet këtij organi, por drejtpërdrejt Ministrisë së Financave. Gjykata vlerëson se një sjellje e tillë institucionale bie ndesh me detyrimin që kanë institucionet shtetërore për të vendosur në vend të drejtën e cenuar të shtetasve, aq më tepër kur shkak për këtë cenim janë vetë këto institucione. Mospërmbushja e detyrimeve ligjore nga institucionet përkatëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë sjellin si pasojë zvarritjen e pajustificuar të procesit, gjë e cila është në kundërshtim me parimet mbi të cilat ngrihet dhe funksionon shteti i së drejtës.

40. Gjykata konstaton se prej vitit 2014, kur vendimi për njohjen e së drejtës së kërkueses ka marrë formë të prerë, deri në momentin e paraqitjes së kërkesës pranë kësaj Gjykate, ndaj kërkueses është zhvilluar një proces i parregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga ana e palës debitore, Ministria e Financave, pa shkak të arsyeshëm. Gjykata vëren se mosekzekutimi për një kohë kaq të gjatë i vendimit gjyqësor të formës së prerë i sjell gjithashtu edhe një dëm financiar të madh shtetit, i cili duhet të vazhdojë të paguajë deri në momentin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Këtë aspekt të pasojave të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore duhet ta mbajnë parasysh të gjitha institucionet shtetërore gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, në mënyrë të veçantë organet gjyqësore, dhe të ndërmarrin të gjitha masat për ta parandaluar rritjen e kostove të panevojshme të buxhetit të shtetit.

41. Në përfundim, Gjykata konstaton se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë, është i bazuar dhe duhet pranuar.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 953, datë 11.3.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

Ishte:

ANEKSI A

PAGESA E REGJISTRIMIT DHE PROCEDIMIT TË NJË APLIKIMI

AKTIVITETI	Licencim	Modifikim	Rinovim	Transferim licence
Operim në impiantet e GNL-së	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Shpërndarje të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Furnizim të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Operim në hapësirat e depozitimit të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Tregtim të gazit natyror	40 000 lekë	30 000 lekë	30 000 lekë	30 000 lekë

Bëhet:

ANEKSI A

PAGESA E REGJISTRIMIT DHE PROCEDIMIT TË NJË APLIKIMI

AKTIVITETI	Licencim	Modifikim	Rinovim	Transferim licence/asetesh
Transmetim të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Shpërndarje të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Furnizim të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Tregtim të gazit natyror	40 000 lekë	30 000 lekë	30 000 lekë	30 000 lekë
Operim në hapësirat e depozitimit të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Operim në impiantet e GNL-së	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja KRISTALINA
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 308 lekë